



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 14

Rrogozhinë, më 23.12.2024 ora 10 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zëvendëskryetarit së Këshillit Bashkiak me Nr.5251. Prot datë 18.12.2024, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.13, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.11.2024.
- 3- Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.
- 4- Miratim i dhënies së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak znj. Lorena Baku.
- 5- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 6- Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për përcaktimin e kritereve për programin ‘Subvencionimi i Interesave të Kredisë’ “.
- 8- Miratim i projekt - vendimit, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”.
- 9- Shqyrtim dhe miratim i Realizimit Faktik të Buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Rrogozhinë.
- 10- Shqyrtim dhe miratim i Relacionit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Rrogozhinë.
- 11- Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025.
- 12- Shqyrtim dhe miratim i shkresës, “Kërkesa për të përfutuar bursë nxënësit që vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Mesëm Profesional për vitin shkollor 2024-2025”.
- 13- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”. (Pikë e mbartur nga mbledhja e datës 30.10.2024).
- 14- Miratim i hartës së plazhit Spille dhe Vilë-Bashtovë, Bashkia Rrogozhinë, në zbatim të



Vendimit Nr.649, datë 16.10.2024 për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’ “.

- 15- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2025”.
- 16- Raport, mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar - Nëntor 2024, vendimet të cilat nuk janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë, si dhe zbatueshmëria e këtyre vendimeve nga ana e administratës së Bashkisë.
- 17- Të ndryshme.
 - Shqyrtim i kërkesës së z. Agush Deda.
 - Të tjera.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Isa Halili, Sokol Gosa, Mitat Daja, Lorena Baku (sapo marrë mandatin), Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Kalemi, Shpati Kolgega, Erind Tosku.

Mungojnë :

Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Mukades Gixhari.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Astrit Mertiri - Administrator i Njesisë Administrative Kryevindh.
3. Deshir Gjumzi - Administrator i Njesisë Administrative Lekaj.
4. Denis Sako - Administrator i Njesisë Administrative Gosë.
5. Mexhit Saliu - Administrator i Njesisë Sinaballaj.
6. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
7. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
8. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
9. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
10. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
11. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
12. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
13. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
14. Gezim Sina - Kryeinspektor i IMTV-së.



15. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
16. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
17. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.

Drejton mbledhjen :

Erind Tosku – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 16- Këshilltarë. Këshilltarët z

HAPET MBLEDHJA

Erind Tosku . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Marrin pjesë në mbledhje Këshilltarët : z. Shpati Kogega, z. Renato Kalemi, z. Enver Memolla, znj. Alime Hoxha, z. Lulzim Hasa, znj. Gezime Met-hasani...

Fatmira Thartori . Erind të lutem më harrove.

Erind Tosku . Unë pashë që ike tani kthehem prap. U bashkua në mbledhjen e Këshillit Bashkiak znj. Fatmira...

Fatmira Thartori . Isha.

Erind Tosku . Ok, znj. Fatmira Thartori, Erind Tosku, z. Hekuran Xhani, znj. Silvana Aliu, z. Indrit Dedej, znj. Lije Dedej, z. Altin Tosku, z. Isa Halili, z. Sokol Gosa dhe z. Mitat Daja. Aktualisht jemi 16-këshilltarë prezentë në mbledhjen e këshillit.

Atëherë lexojmë vendimet e mbledhjes së fundit të këshillit bashkiak të datës 20.11.2024.

-Lexojmë vendimet e mbledhjes së fundit të këshillit bashkiak të datës 20.11.2024 :

Vendim nr .55. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .



Vendim nr .56. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

-Këto Vendime duke qenë akte me karakter individual, hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar.

Erind Tosku . Kalojmë në rendin e ditës jeni dakord të ... Po, në rendin e ditës është bashkuar një projektvendim “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Ky projektvendim ka ardhur me datë 20, që shtë shtuar pjesë e buxhetit për shlyerjen e detyrimeve që ka bashkia. Një fjalë sqaruese kryetari.

Edison Memolla . Atëherë përshëndetje! Faleminderit që jeni prezentë sot. Ky projektvendim realisht është miratuar me datë 20, zbardhur ditën e Shtunë, se këto janë fonde që duhet të përdoren brenda vitit është akorduar nga qeveria shqiptare një fond rreth 15 milion lekë ose 150 milion lekë të vjetra dhe këto janë për detyrimet e prapambetura, ë nisin kush është më i vjetri dhe kush ka më shumë borxhe që i kemi ne kundrejt operatorëve të jashtëm. Kështu që ne menduam që ta sjellim sepse kjo kalon gjithmonë në këshill bashkiak që të mos bëjmë një mbledhje të dytë dhe nëse jeni dakord ta kalojmë në rend dite.

Erind Tosku . A jeni dakord ta vendosim në rendin e ditës këtë projektvendim?

Indrit Dedej . Ka mundësi të flas. Ne nuk jemi dakord për asnjë lloj shtese sepse edhe kjo një edhe kjo dy, kjo do kohë që ta shohim ta zbërthejmë edhe kështu që ne e kemi thënë dhe stërthënë që ne mos të na vijnë projektvendime në kohë të fundit në mbledhje. Kështu që ne jemi kundra, flas për pjesën që...

Erind Tosku . Shkresa kjo tjetra Indrit është gabim që shtë bërë tek pjesa e dokumentacionit, që nuk është futur tek pjeda e kësaj vetëm projektvendimi për shlyerjen e detyrimeve...

Indrit Deej . Kryetar edhe njëherë dokumnetacioni në tërësi për 10 ditë ne nuk jemi profesionistë për 10 ditë të vijë një buxhet i bashkisë ... edhe ti e mban mend shumë mirë kur kemi qenë në trajnim bashkë, komisioneri çfarë tha, në momentin që vjen 10 ditët e fundit tha, në mënyrë kategorike nuk duhet të kalojë buxheti tha.

Erind Tosku . E hedhim në votim.

Indrit Dedej . Në votim hidheni ju.



Erind Tosku . E hedhim në votim projektvendimin ta shtojmë në rend dite...?

Mitat Daja . Vetëm për sqarim, pra ky vendim që ka ardhur thjeshtë kanë ardhur fonde nga qeveria edhe do merret ... o Indrit ta kuptojmë.

Edison Memolla . Nuk do ta votojë vazhdo ti.

Mitat Daja . Nuk është se e ka sjellur Bashkia vijnë fonde nga jashtë nga qeveria...

Indrit Dedej . Jam dakord duhet ta kishin pas sjellur.

Edison Memolla . Me datë 20 ka kaluar në parlament me datë 21 ka ardhur.

Erind Tosku . Edhe njëherë ju lutem këshilltarë që të kemi numrin e saktë. E hedhim në votim. Në rregull miratohet.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 3 (tre) vota kundër (S.Aliu, I.Dedej, L.Dedj) , 0 (zero) vota abstenim përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit, me shkresë Nr.5279.Prot datë 23.12.2024 “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Enver Memolla . Erind bëje procedurën e plotë sa janë kundra, abstenim.

Erind Tosku . Po, kundra janë 3.

Hekuran Xhani . O Indrit tani si grup, ne jemi një grup grupi i opozitës meqë ky fond akordohet nga qeveria është për shlyerjen e borxhit...

Indrit Dedej . Nuk jam në kundërshtim.

Hekuran Xhani . Prit tani, ne kemi ne paragjykojmë mënyrën se si ka ardhur në afatet e duhura por edhe ne si opozitë nuk jemi kundër një shlyerje borxhi që në fund të fundit nuk e ka as kryetari, as këshilli e kanë qytetarët. Është një borxh që do të paguhet nga tasat e qytetarëve të bashkisë Rrogozhinë, shteti na ndihmon për shlyerjen e këtij borxhi, kështu që edhe ne si opozitë nuk jemi kundër shlyerjes së borxhit që ka bashkia.

Indrit Dedej . Unë të njoftohem siç e kërkon ligji o shoku.



Edison Memolla . Ka kaluar ditën e Premte në parlament ditën e Shtunë ...

Hekuran Xhani . Tani çështja e rendit të ditës ka të drejtë Indriti që pse nuk ka ardhur, shpjegimi që jep.

Indrit Dedej . Ne dy kemi qenë që kemi votuar kur ka qenë borxhi që erdhi zyra përmbarimore. Unë nuk jam kundra lëre për herë tjetër edhe kjo këtu, unë nuk jam profesionist të shoh shifrat e këtyre, përrallat e këtyre ja.

Erind Tosku . Atëherë jemi 12 pro dhe 3 kundër. Je abstënim?

Indrit Dedej . Jo unë jam kundra komplet, por po them nuk jam kundra kalimit të këtyre.

Erind Tosku . Ok, në rregull. Për miratimin e kësaj projektvendimi...

Indrit Dedej . Jam kundra.

Erind Tosku . Ok, kundra.

Hekuran Xhani . Është kundra procedurës jo kundra vendimit prap ta sqarojmë. Meqë nuk ka ardhur në afat Indriti shprehet, herë tjetër të kihet parasysh të vijë brenda afatit.

Erind Tosku . Miratim i procesverbalit Nr.13, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 20.11.2024. E hedhim në votim, procesverbalin sapo e lexova. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, pika 2 (dy) e rendit të ditës.

Erind Tosku . Atëherë pika 3, Shqyrtim i vlefshmërisë së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili. Të kalojmë në diskutim për pjesën e vlefshmërisë së mandatit të z. Isa Halili për vlefshmërinë e tij. Kështu që ndonjë diskutim në raport me këtë?

Shpati Kolgega . Po, është mbledhur komisioni i mandateve ka shqyrtuar vlefshmërinë e mandatit nga procedura rezulton që mandati nuk është i vlefshëm për shkak se ka mospërputhje me kuadrin ligjor atë që ka të bëjë me zgjedhjet. Dhe kjo është vërtetuar në dy pika, në dy raste sepse Isai ka qenë anëtar dhe i KQV-së por dhe në ZAZ dhe kjo është e vërtetuar me listë pagesa me listat që janë çuar në KZAZ. Kështu që komisioni e gjen në mospërputhje mandatin e z. Halili, dhe në këtë situatë vjen një shkresë që i është dërguar KQZ-së mbi kompetencat dhe



vendimarrjen përsa i përket mandateve është kompetencë e këshillit bashkiak që të shqyrtojë vlefshmërinë ose jo të mandatit. Qartazi është në mospërputhje përtej të gjithë le të themi njohjeve personale por ligjërish komisioni i mandateve e gjen në mospërputhje.

Erind Tosku . Të flasi z. Isa që dhe ne të jemi...

Shpati Kolgega . Më fal unë thashë pjesën e komisionit, pastaj për vendimarrjen ose jo do duhet diskutuar.

Fatmira Thartori . A mund të bëj një pyetje të drejtpërdrejtë Isa? Sa kohë ke këtu që je këshilltar?

Isa Halili . Më shumë se 6-muajsh.

Fatmira Thartori . Si ka mundësi që Komisioni Qëndror i Zgjedhejve pas 6-muajsh gjen të pavlefshëm mandatin e ...?

Isa Halili . Jo nuk është komisioni qëndror... komisioni qëndror në se do më kishte gjetur nuk do ma kishte dhënë mandatin.

Fatmira Thartori . Jo në momentin e parë direkt, sa ka dalë emri Isait të kishte kaluar tek tjetri ai e sjell Isain këtu.

Shpati Kolgega . Tani kërkesë i është bërë KQZ-së dhe KQZ e ka kthyer përgjigjen dhe thotë është kompetencë e këshillit bashkiak. Në qoftë se këshilli bashkiak e gjen në shkelje atëherë çohet për votim në këshill dhe është këshilli që vendos, pra janë anëtarët e këshillit që vendosin, KQZ thotë ju verifikojeni se e keni kompetencën i keni dhe kushtet për këtë punë dhe jeni dhe kompetentë në këtë punë, nëse e gjeni në shkelje çojeni për votim, këshilli pastaj merr vendim. Pra kjo është e qartë nuk ka nevojë për diskutim është apo nuk është në mospërputhje sepse është qartazi në mospërputhje.

Isa Halili . Tani kjo është ne njihemi këtu të gjithë me njëri tjetrin dhe vendimi në lidhje për vlefshmërinë e mandatit tim vjen si pasojë e përplasjeve personale që unë kam këtu me grupin e partisë demokratike dhe kryesisht me kryetarin që nuk është këtu që përfaqëson këtë parti politike. Nëse mandati im do ishte i pavlefshëm Komisioni Zgjedhor i Zgjedhjeve nuk do të ma jepte fuqinë që unë të isha këtu mes jush, e para, e dyta më duhet të ju informoj që me datë 14 Maj unë jam informuar për hir të së vërtetës për të qenë transparent me ju mbase shumë këtu e



dinë duke qenë dhe kryetar i partisë që unë përfaqësoj, kam marrë vesh që kam qenë në listën e anëtarëve për këshilltar të partisë republikane. Më ka informuar një anëtar i partisë socialiste se nuk vazhdonte komisioni zgjedhor aty, pra nuk fillonte procesi i votimit në qoftë se unë nuk do merrja një vendim në lidhje me këtë gjë. Në këtë moment kam kontaktuar kryetarin tim të partisë që ishte edhe drejtues ligjor që përfaqësonte procesin zgjedhor të 14 Majit për kryetarin e bashkisë të ri të Rrogozhinës që do zgjidhte aso kohe dhe në atë moment unë jam tërhequr si anëtar komisioni. Në atë moment jam larguar nga qendra e votimit që është lart se nuk e di me numra tani por që di si vend tek stacioni i trenit. Për të qenë transparent prap edhe pse e dija shumë mirë se ishte një qendër votimi shumë e nxehtë duke ditur rivalitetin politik dhe shumë çka tjetër. Unë nuk e di se çka bërë kryetari në këtë rast që vjen gjithë kjo histori se çfarë ka shkruar në letra por di të them një gjë tjetër meqenëse jam informuar që unë me demok paskam marrë lekë pra ka letra aty unë më duhet të ju them dhe kam dokumente këtu që e vërteton që tek ajo lista kryetari im i partisë fatkeqësisht aty ka njerëz ju e njihni shumë mirë unë do bisedoj dhe argumentet që nuk kanë lidhje nuk kanë qenë fare në Shqipëri dhe vendosen emrat në mënyrë më të përgjegjshme që këto lekë bashkë me njerëz atje tek posta të marrin këto lekë. Unë kam qenë ju e dini shumë mirë edhe kam qenë tek procesi i numërimit të votave por emri im nuk ishte aty sepse aty paguhet 100 mijë lekë dhe do t'i marri dikush tjetër ato lekë. Kam dhënë dorëheqjen dhe nuk kam qenë jashtë dhe për këtë janë njerëz të tjerë që mund ta konfirmojnë këtë lloj gjëje, ajo që unë jam duke thënë këtu është që kjo kuptohet .

Shpati Kolgega . Më fal që të ndërpres po thua që ke qenë komision por lekët nuk i ke marr.

Isa Halili . Nuk kam qenë as në komision dhe sipas informacioneve që unë kam... nuk kam qenë në komision se unë jam larguar se nëse unë do të isha në komision , do të kisha dhënë të paktën dorëheqjen si ... pra tek lista e anëtarit të këshillit. Pra janë dy gjëra që nuk ndodhin me njëra tjetrën pra o unë do jap dorëheqjen nga kjo lloj gjëje ose do dilja... në dijeninë time aty ka qenë nuk e di një anëtar i partisë social demokrate në mos gaboj me mbiemër Kasa dhe nuk e di se kush ishte që ka ardhur aty dhe unë kam qëndruar në ambientet e jashtme me demok si përgjegjës i kësaj gjëje dhe nuk kam qenë fare anëtar. Dhe këtë ju mund ta konfirmoni këtë me anëtarë aty ka qenë Aleksandër Sheshi anëtar ka qenë një me mbiemër Saraçi në mos gaboj nga Gosa kanë qenë anëtarë të komisionit të partisë socialiste që e vërtetojnë këtë lloj gjëje. Tani unë e di që kryetari im i partisë ndoshta nuk është këtu njeriu për të folur dhe ndoshta nuk është mirë që ne ta përmendim shumë herë por kjo është e vërteta se ai është kryetari i partisë është avokat ndër tjera dhe merret me këto gjëra dhe do të gjejë një pikë...

Silvana Aliu . Kryetari i PR-së? Se je me PR-në.



Isa Halili . Jo jo unë po them kryetari i partisë demokratike. Nëse doni ta dini për transparencë unë nuk jam as anëtar i partisë Republikane as anëtar i partisë demokratike. Jam një qytetar i këtij vendi që një sigël partie ka vendosur emrin tim dhe e ka parë të arsyeshme për të qenë në një nga listat e një partie atje dhe qytetarët kanë vendosur që të jem i zgjedhuri i tyre për shkak se kryetari i partisë republikane dha dorëheqjen dhe ju e dini shumë mirë dhe një sërë emrash të tjerë kanë qenë të parët në listë me mua, kanë dhënë dorëheqjen dhe erdhi im. Unë e thashë dhe njëherë nuk e kam ditur fare e kam marrë vesh me datë 14, jam larguar nga komisioni, aty sipas informacioneve që unë kam, se unë kam pasur dhe punët e mia ju e dini shumë mirë nuk kam qenë i interesuar fare, ka një listë pagesë që paska marrë lekë atje nuk është absolutisht e vërtetë kjo gjëja unë nuk e di se kush firmos dhe kush i merr këto lekë dhe ajo që unë di të them është kjo që ka njerëz pa fund tek ajo lista aty që unë e kam marrë dhe e kam në dorëzim që nuk janë fare aktiv dhe nuk kanë qenë pjesë e procesit fare zgjedhor të 14 Majit 2023 dhe që janë aty.

Erind Tosku . Këto i keni me dokumentacione?

Isa Halili . Po, patjetër.

Mitat Daja . Komisioni i mandateve që është mbledhur për këtë punë e ka thirrur ndonjëherë të nderuarin për ta pyetur ka qenë apo nuk ka qenë? Se janë mbledhur me një nxitim shumë të madh për të bërë një gjë të tillë.

Isa Halili . Dhe doja ta thoja këtë i painformuar, jam informuar pasi e kam marrë unë Ervisin, në lidhje me këtë gjë.

Mitat Daja . Është informuar nga rendi ditës që keni nxjerrë ju aty.

Indrit Dedej . Ka mundësi zoti sekretar me letrat që ke marrë nuk na i ke dhënë.

Mitat Daja . z. Kryetar, Këshilli Bashkiak është informuar në mbledhjen që shkoi për këtë problematikë, se duhet të ishte informuar?

Isa Halili . Është e drejtë legjitime e secilit të paktën e imja në këtë rast.

Mitat Daja . Ju duket normale ju si këshilltar që të paktën rendi i ditës sidomos vlefshmëria e mandatit ta marrim vesh gjithë bota dhe ne si këshill nuk jemi të informuar për vlefshmërinë e mandatit të zotërisë.



Silvana Aliu . Nëse ti nuk do ishe aq shumë i informuar nuk do më shkruaje mua 500 herë në telefon...

Mitat Daja . Nuk po flasim për marrëdhëniet personale ne po flasim për marrëdhëniet zyrtare. Atëherë pyetja që unë i drejtoj këshillit bashkiak dhe që ta dëgjojë dhe publiku se kjo është shumë e rëndësishme se ndoshta ju keni marrë një vendim politik dhe do merreni me këtë punë por është e drejta e secilit edhe nëse ne nuk jemi dakord. Pyetja që i drejtova komisionit të mandateve, a duhet që të vihet në dijeni personi për përpunueshmërinë e mandatit që mandate i tij nuk është në përputhje me ligjin, e thirrret personin? Shpati si kryetar i komisionit të mandatave apo jo?

Isa Halili . Nuk ka qenë fare në dijeninë time.

Shpati Kolgega . Komisioni i mandatave nuk është komision hetimor që të thërrasë dëshmitar...

Mitat Daja . Në dijeni...

Shpati Kolgega . Më fal, nuk është komision hetimor që të thërrasë dëshmitar që në këtë rast të mund të ishit edhe ju që keni qenë në KZAZ apo KQV apo dhe tjerë...

Mitat Daja . Kur jeni mbledhur ju?

Shpati Kolgega . Është një komision që konstaton në bazë të dokumentave në qoftë se ka dikush që ka falsifikuar këto dokumente atëherë ai dikush mban përgjegjësi por komisioni konstaton në bazë të dokumentave dhe kjo është e thjeshtë ka ardhur një kërkesë... Më fal ta mbaroj se po më merr ti në pyetje tani... dhe për të ju përgjigjur kërkesës së znj. Thartori ka pasur një kërkesë për verifikimin e mandatave se deri para këtij momenti nuk ka pasur asnjë informacion në moment që erdhi informacioni u mblodh këshilli, komisioni dhe e verifikoi...

Mitat Daja . Kur është mbledhur komisioni?

Shpati Kolgega . E ke me dokumentacion se kur është mbledhur komisioni. Kështu që komisioni është mbledhur ka parë letrat është vërtetuar dhe kaq. Tani se çfarë thonë gojarisht ka institucione tjera që jua vërtetojnë...

Mitat Daja . A është mbledhur komisioni apo jo?



Shpati Kolgega . Patjetër që është mbledhur komisioni.

Mitat Daja . Para kësaj mbledhjeje?

Shpati Kolgega . Po, para kësaj mbledhjeje. Nëse ka pretendime nga palët ne nuk jemi komision hetimor të marim njerëzit në pyetje, sipas letrave ekziston nëse ai ka të drejtë gjykata ka, shpresoj shumë që të ketë të drejtë, ta fitojë dhe të vazhdojë nuk ka asgjë të keqe. Por ne shohim dokumentet nuk dimë nëse ka qenë jashtë ka qenë brenda. Ai mund të ketë shumë pretendime dhe është në të drejtën e vet të mbrohet nuk diskutohet por nuk jemi ne që ja vërtetojmë dot fjalët se ne nuk jemi as prokuroria ne shohim dokumentet, sipas dokumenteve ai ekziston tani, shpresoj që të mos ishte ashtu apo të mos jetë kështu.

Silvana Aliu . Filloi duke thënë nga akuzat që bëhen se ekzistojnë anëtarë që marrin vetëm pagesën nuk besoj që pagesa të kalojë në postë dhe të bëhen të tilla gjëra në 2024, kjo nuk ka shansin të ndodhë dhe nuk ka shansin një kryetar të shkojë dhe të marrë pagesën për pesë a gjashtë a dhjetë siç mund të thoni ju që nuk ekziston, e para. E dyta ekzistojnë kamerat, çdo qendër votimi ka kamera dhe për faktin që ishit shumë të emocionuar sepse do vinit drejtora dhe do vinit me poste shumë të larta dhatë dorëheqjen keni nënshkruar dhe kryetari Nazmi Totraku nuk e ka dërguar shkresën që ti ke dhënë dorëheqje nga anëtar këshilli bashkiak dhe ke ndenjur deri në fund. Nëse ky këshill bashkiak kundërshton ligjet që ka vendosur vetë shteti, vetë komisioni zgjedhor atëherë ok ne i çojmë një letër komisionit që ne nuk pranojmë të zbatojmë ligjet e juaja dhe vazhdojmë.

Indrit Dedej . Unë si anëtar KZAZ-je në më shumë se 4-5 zgjedhje , kam qenë anëtar KZAZ-je tek zona 43, ka qenë Eltoni, Nazmiu nuk ka shans që të bëhesh anëtar këshilli po mos firmosësh po mos sjellësh dokumentacionin nuk pranohen nga KZAZ nga sekretari ai Beti. Kështu që zotëria ka plotësuar formularët siç i kërkon ligji dhe në momentin që ka bërë dorëheqjen puna e tij sepse rezulton një shkresë mund ta kenë sekretariati Totraku ose ai zoti Beti që është në Durrës që mund të ketë bërë një shkrim dore sepse ashtu funksiononte... hajde zëvendëso këtë bëj dorëheqje dore dhe futesh direkt, sepse edhe listat që çonim ne për anëtarë QV-je personat nuk vinin në momentin që nuk vinin kishin të drejtë direkt nga KZAZ t'u zëvendësonin sepse listat shkojnë në KQZ lart. Është afat i shkurtër ne i zëvendësonim direkt me urdhër të KQZ Nr. 43 sa është, kështu ka ndodhur dhe nuk ka shans që pagën time ta marrë një tjetër, apo nuk është kështu Ver?

Alime Hoxha . Tani meqenëse këtu po dalin ... se komisioni i mandateve e ka marrë vendimin sipas ankesës që është bërë se i është drejtuar një kërkesë KQZ-së për verifikimin e mandatit të z.



Isa Halili. KQZ-ja e ka sjellë shkresën për kompetencë të këshillit dhe komisioni i mandateve duke parë aq dokumentacion që kishte e pa të arsyeshme që personi ka shkelur ligjin. Tani meqënëse personi vetë dhe nga dokumentet që po thotë Silvana jo ka dhënë dorëheqjen jo nuk e ka dhënë, unë jam e mendimit që ne ta shtyjme këtë vendim deri sa personi të na paraqesi dokumentacionin ku vërteton që a ka dhënë dorëheqjen nga qendra e votimit ose ka dhënë dorëheqjen nga anëtari i i këshillit nuk e di. Deri sa ne të kemi në dispozicion këto dokumente që na vërtetojnë që zotëria nuk ka qenë pjesë e komisionit zgjedhor apo e vendimit unë propozoj, ta shtyjme zotëria duhet të jetë i pezulluar deri në momentin sa të...

Shpati Kolgega . Atëherë në mbështetje të kësaj që u tha edhe propozoj ta hedhim në votim për ta shtyrë në mbledhjen tjetër dhe ndërkohë ne marrim kohë për dokumentacion shtesë për rastin ndërkohë që anëtari mbetet i pezulluar deri në votimin për ligjshmërinë ose jo të mandatit.

Lulzim Hasa . Komisioni i mandateve ta thirri të japë sqarimet, të paraqitet tek ju...

Shpati Kolgega . Të paraqitet por ne nuk e marrim në pyetje të sjelli dokumentet, muhabet dalim bëjmë nuk është çështja që ne ta marrim në pyetje po ai të vijë të japë shpjegime ne duam dokumente...

Isa Halili . Më fal kjo procedurë dhe kjo lloj linje llogjike do duhjet të ishte bërë përpara marrjes së këtij vendimi, pra në momentin që ju do mblidheshit aty, e para më së paku e drejta ime legjitime është që unë duhet të isha informuar...

Shpati Kolgega . Kjo e saktë fare do ishte që ti je në shkelje dhe sot të merrej vendimi të hiqej mandati por ne po të japim kohë që ti të sjellësh dokumentet...

Isa Halili . Në shkelje të kujt... Cilat janë faktet?

Hekuran Xhani . Tani duke dëgjuar kryetarin e komisionit të mandateve dhe anëtarët e komisionit të mandateve të maxhorancës dhe të opozitës këtu thuhet që ka shkelje, ti me argumentet tua thua që unë nuk kam bërë shkelje. Kjo është fatkeqësi për grupin tonë që kjo ndodh po brenda opozitës dhe do bëhemi po ne... Unë të bëj thirrje të grumbullosh gjithë dokumentacionin përkatës që ti po e përmbledh këtu me argumente me gojë ti sjellësh ato me shkrim edhe siç ka vendosur komisioni nuk ka asnjë të keqe se ne edhe të marrim një vendim për të të mbajtur ty nëse është shkelur ligji nuk ka këshill sepse ai që i heq dhe e përcakton është ky është KQZ Tiranë. Nëse emri atje shkon dokumenti ti duhet të sjellësh këtu kundërgargumentet që



ne të shprehemi pastaj lidhur me qëndrimin tënd edhe unë mbështes propozimin e Shpatit dhe Silvanës Alimesë që kjo punë të mbetet për mbledhjen tjetër.

Erind Tosku . Po, ta mbyllim me këtë se u krijua ideja e qartë.

Mitat Daja . Atëherë unë i kërkoj dhe komisionit të mandateve t'i vejnë në dispozicion Isait ato argumente që ato kanë.

Hekuran Xhani . Kjo është plotësisht e drejtë.

Mitat Daja . Sepse ai është i pafajshëm dhe nuk ka pse ta mbrojë pafajësinë ai nëse është i fajshëm do mbrohet pastaj. Ju i jepni dokumentacionin e duhur që e ka firmosur që ka marrë pagesat ka bërë këtë ka bërë atë dhe në bazë të këtij dokumentacioni që e ka të bëjë mbrojtjen e vet.

Isa Halili . Se kemi dhe Verin këtu mesa jam në dijeni edhe aty në qoftë se kam tërhequr lekë aty tek Posta juaj , pra në qoftë se kam tërhequr aty, aty a kamera.

Erind Tosku . Atëherë me propozimin e kryetarit të mandatit...

Mitat Daja . Fillimisht para, komisioni i mandateve ti vejë në dispozicion ...

Erind Tosku . Mitat mos e ki problem se nuk e kanë të fshehtë ato.

Shpati Kolgega . (lexon shkresën) Isa Besnik Halili, anëtar Nr personal, pagesa bruto, firmosur Nazmi Totraku Kryetar, Elis Kacani Nënkyetar i KZAZ firma vula.

Hekuran Xhani . Tani o Shpati ne këto i dëgjuam, ky dokumentacion në bazë të ligjit i jepet, i dorëzohet personit ...

Shpati Kolgega . Po se tha nuk kemi dokumentacion.

Erind Tosku . Me propozimin e kryetarit të mandateve, dashamirësia e kryetarit është që të kemi dhe pjesën e të dyja palëve dokumentacionin siç thatë ju për të hedhur poshtë atë dokumentacion. Me propozim të kryetarit të mandateve e kalojmë në votim për shtyrje të këtij vendimi dhe pezullimin deri sa të marrë vendim këshilli ...

Isa Halili . Po pse duhet të pezullohet?



Mitat Daja . Pse duhet të ketë masë?

Alime Hoxha . Sepse unë e kam dokumentin që ai ka qenë...

Erind Tosku . Çfarë duhet të ketë z. Mitat?

Isa Halili . Merr vendim nuk jam për lëmoshë nuk pezullon dot.

Erind Tosku . Jeni dakord këshilltarë për shtyrjen e mandatit për shtyrjen e votimit të mandatit të z. Isa Halili?

Mitat Daja . Për shtyrjen e votimit po.

Erind Tosku . Ok në rregull. Pra. z. Sokol po apo abstenim për shtyrjen e vendimit se nuk po e shikoj dorën? Ok, në rregull. Janë 14...

Isa Halili . Kryetar më fal pse duhet të jem i pezulluar për çfarë motivi? Sepse përderisa nuk ka një masë që përcakton pse duhet të jem i pezulluar për çfarë?

Hekuran Xhani . Isa ta përcakton ligji.

Erind Tosku . Deri në mbledhjen e radhës.

Isa Halili . Po jo me jo fare pse?

Hekuran Xhani . Komisioni i mandateve të ka gjetur në shkelje të ligjit.

Isa Halili . Shumë mirë të marrë vendim e të iki. Një sekondë nuk është këtu momenti fare për lëmoshë. Në qoftë se ata janë të bindur për argumentet që kanë të marrin vendim në qoftë se këta nuk marrin vendim unë nuk kam pse të bëhem i pezulluar ka dy gjëra që duhet të ndodhin.

Hekuran Xhani . Morëm vendim u votua.

Isa Halili . Jo pezullim kujdes. Për pezullimin flasim se pezullimi është një çështje tjetër pastaj për vendimin jam dakord, pezullim ska pse.

Shpati Kolgega . Do pezullohesh sepse je në shkelje.



Isa Halili . Po merrni vendim për çfarë po e shtyni?

Shpati Kolgega . Është këshilli që e vendos.

Isa Halili . Për shtyrjen ok, nuk kam pse të jem i pezulluar është e palogjikshme kupton nuk ka sens llogjik.

Shpati Kolgega . Je 100% në shkelje tani, stop tani ...

Isa Halili . Atë fjalën stop tërhiqe mbrapsht.

Shpati Kolgega . Ore je në shkelje je me dokumente në shkelje.

Isa Halili . Po shumë mirë, jo fjalë “ore”.

Erind Tosku . Kalojmë tek pika 4...

Mitat Daja . Të qartësohen gjërat që mos rrinë gjërat e paqarta...

Erind Tosku . Janë të qartësuara gjërat në momentin që u hodh në votim u qartësuan gjërat.

Mitat Daja . Edhe njëherë tjetër, u shty marrja e vendimit dhe pezullimi është vendim o shoku im.

Erind Tosku . U bënë të dyja kur hodhëm pjesën e votimit i kaluam të dyja bashkë.

Mitat Daja . Ke bërë vetëm një.

Erind Tosku . Po pse? Pse Mitat se e doni ju.

Shpati Kolgega . Ta hedhim dhe njëherë në votim?

Isa Halili . Jo nuk është puna me e hedhur në votim.

Erind Tosku . O z. Shpati kalojmë tek pika se kemi buxhetin pikën më të rëndësishme për të diskutuar. Miratimin e dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Lorena Baku. Pasi jemi njohur me vendimin e KQZ për dhënien e mandatit të këshillit znj. Lorena Baku,



mbështetur dhe në propozimin e komisionit të mandateve, kalojmë në procedurën e betimit. Anëtarja dhe zëvendëskryeari çohen në këmbë për të bërë betimin e këshilltarit.

Hekuran Xhani . Kam një pyetje përpara unë. Shpati vazhdon ngelet kryetar i komisionit të mandateve mos na ndodhi e njëjti precedent si puna Isait është verifikuar zonja nuk kemi asgjë me zonjën ta gëzojë mandatin po mos na dalë që ka qenë ndonjë anëtare në qendër votimi ose mund të na përgjigjet drejtpërdrejt vajza që mos shkojmë prap precedentë si puna Isait dhe jemi të gatshëm ta votjmë pastaj nëse nuk ka shkelje.

Indrit Dedej . Kryetari komisionit i ka sekretari i këshillit bashkiak i ka komplet dokumentacionet e duhura që ta paraqesë para Shpatit sepse kryetari i financave ja ka sjellë Visit pagesën në momentin që nuk është në listë pagesë zonja ka të drejtë ta gëzojë mandatin.

Hekuran Xhani . Pyetjen ja bëra Shpatit, le të shprehet Shpati si kryetar i komisionit të mandateve dhe ne jemi dakord.

Shpati Kolgega . Në këtë situatë zonja për sa i përket komisionit është verifikuar dhe është në rregull.

Indrit Dedej . Në rregull ta gëzojë mandatin.

Erind Tosku . Atëherë zonja Lorena Baku çohet në këmbë. Formula e betimit. Beto hem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Beto hem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Rrogozhinë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqënies së tyre. Beto hem.

Lorena Baku . Beto hem.

Erind Tosku . Suksese. E hedhim në votim për dhënien e mandatit të znj. Lorena Baku. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim dhënia e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Lorena Bujar Baku.

Vendim nr .57. Miratohet me 15-vota pro, dhënia e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Rrogozhinë znj. Lorena Baku, propozuar nga komisioni i mandateve, mbështetur në vendimin e



KQZ-së Nr.197, datë 27.11.2024, “Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Rrogozhinë, me kandidatin nga lista shumëmërore e ‘Partisë Socialdemokrate’ znj. Lorena Bujar Baku.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 5, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i Bllok - Ndhmës 6%”. Relaton për drejtorinë e mbrojtjes dhe kujdesit social, specialistja e ndihmës ekonomike znj. Suela Proshka, pasi drejtori është me leje. Po znj. Suela afrohu.

Suela Proshka . Atëherë të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak kemi përgatitur projektvendimin për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i bllok ndihmës 6%. Atëherë kriteret janë përcaktuar në ligjin nr.159/2019 “Për dhënien e ndihmës ekonomike” dhe shkurtimisht të gjitha familjet jo përfituese nga sistemi i ndihmës ekonomike të cilat janë përzgjedhur përfituese kalojnë në rekomandim të 6 %.

Erind Tosku . Ndonjë pyetje për pikën 5?

Indrit Dedej . Meqë shefi ka marrë leje ai është shumë i rregullt... sa gjysma shefit tënd të kishte ca drejtori tjera ...

Erind Tosku . Ndonjë pyetje? E hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika pika 5 (pesë) e rendit të ditës.

Vendim nr.58. Miratohet me 15-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5171.Prot datë 13.12.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i Bllok – Ndhmës 6%”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5171/1.Prot datë 13.12.2024.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 6, Miratim i projekt-vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”. Relaton po znj. Suela Proshka.

Suela Proshka . Atëherë ashtu sikurse dhe projektvendimi për 6 % vetëm se në këtë rast fondet janë nga pushteti vendor pra ofrohen nga bashkia, kriteret janë po të njëjta dhe është përgatitur dhe lista e përfituesve. Ndryshimet bëhen çdo tre muaj futen emra të rinj.



Erind Tosku . E kalojmë në votim pikën 6. Po, pika 6 të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, pika 6 (gjashtë) e rendit të ditës.

Vendim nr .59. Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.5132.Prot datë 11.12.2024 , “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor”, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5132/1.Prot datë 23.12.2024.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 7, Miratim i projekt-vendimit, “Për përcaktimin e kriterëve për programin ‘Subvencionimi i Interesave të Kredisë’ “. Relaton për drejtorinë e Mbrojtjes dhe Kujdesit social znj. Suela Proshka.

Suela Proshka . Atëherë për sa i përket subvencionimit të interesave të kredisë shkurtimisht do paraqes një relacion shpjegues në lidhje me përcaktimin e kriterëve, fazën e aplikimit dhe kriteret e përzgjedhjes. Në total do jenë 8 kredi të ofruara për qytetarët e bashkisë Rrogozhinë dhe prioritet do të kenë bashkëshortët dhe çiftet e reja ku anëtari më i madh i familjes duhet të jetë më i vogël ose deri në 40 vjeç. Familje që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, gra të dhunuara apo me status të njohur nga gjykata por gjithashtu nuk bëjnë përjashtim edhe rastë të tjera që vijnë nga familjet në nevojë. Përsa i përket kriterëve, kriteri kryesor siç dihet është të mos kenë në pronësinë e tyre pasuri ose shtëpi, gjithashtu dhe niveli i të ardhurave duhet të jetë i konsiderueshëm. Sistemi i pikëzimit në total përmban 100 pikë dhe ndahet në 4 kategori kryesore, janë kushtet e strehimit, kushtet sociale, kushtet ekonomike dhe kushtet familjare. Secili nga këto kategori përmbajnë disa pika që në total japin 100 pikë në tërësi dhe pastaj në varësi të pikave që do të mbledhi secili aplikues do të përzgjidhen dhe përfituesit. Aplikimi kalon në dy faza, faza e parë është pasi ky projektvendim kalon nga këshilli bashkiak dhe Prefektura atëherë gjithë qytetarët e bashkisë Rrogozhinë kanë të drejtë që brenda 30 ditëve kalendarike të bëjnë regjistrimin në portalin qeveritar e-albania. Në këtë portal ato do të plotësojnë kërkesën për të përfituar nga programet e strehimit social dhe këtë formular duhet ta dorëzojnë pranë zyrave të Shërbimit Social bashkë me dokumentet e tjera përkatëse. Përzgjedhja e përfituesve më pas siç edhe e përmenda i është dhënë prioritet kategorive që i përkasin shtresave në nevojë, gjithsesi nuk do të ketë përjashtime dhe për grupe të tjera.

Erind Tosku . Ndonjë pyetje për pikën 7-të?

Mitat Daja . Sa është përqindja e subvencionit që bëhet? Sa është kredia reale që merr personi që do përfitojë këtë, e para?



Suela Proshka . Atëherë përqindja është llogaritur deri në 3%.

Mitat Daja . 3% e paguan personi apo e paguan...?

Suela Proshka . 3% e paguan institucionet...

Mitat Daja . Atëherë ta dëgjonë dhe njerëzit, personi që merr kredi do paguajë një përqindje 3 % të interesit të pandryshueshme për aq vjet sa do e marri nuk është zero?

Suela Proshka . Jo nuk është zero.

Mitat Daja . Po prandaj u diskutua që nuk është zero. Dhe gjëja tjetër është çiftet e reja, se keni përmendur tek kriteret, ka çifte që martohen duan shtëpi të re përse nuk e keni përfshirë?

Suela Proshka . Po është dhënë është një nga kriteret çiftet e reja ku dhe anëtari më i madh.

Mitat Daja . Po i keni bërë çiftet e reja shuma e moshës mos kalojë 80 vjeç.

Suela Proshka . Atëherë çiftet e reja ku anëtari më i madh i familjes duhet të jetë më i vogël ose i barabartë me 40 vjeç, pra një nga katëgoritë janë çiftet e reja.

Mitat Daja . Ajo thotë familje të reja me fëmijë në ngarkim, shuma e moshës mos kalojë 80 vjeç.

Suela Proshka . Shuma e moshës në total për gjithë anëtarët në familje.

Mitat Daja . Pra i bie që të martohemi 40-vjeç të përfitojmë këtë.

Suela Proshka . Maksimumi deri në 40-vjeç.

Shpati Kolgega . Deri në sa është kredia që jepet?

Mitat Daja . Sa dhe a është e mundur që të vendoset për çiftet e reja?

Shpati Kolgega . Sa është shuma e kredisë që jepet?

Suela Proshka . Atëherë për shumën me thënë të drejtën...



Indrit Dedej . Atëherë ne kemi pasur përvojë të paktën në kohën time, kemi pasur përvoja të tilla edhe familjarët përfitojnë në bazë të numrit të personave në familje, nëse janë burrë e grua fitojnë një dhomë një kuzhinë një vlerë x, 24 milion lekë ku di unë që mbaj mend në qoftë se janë 6 persona përfitojnë tre dhoma dhe kuzhinë dhe kështu përcaktohet e ndan numri familjarëve. Sa më shumë anëtarë aq më shumë, pastaj afatet janë të përcaktuara sipas buxhetit që mund të ketë mund të jetë për 20 vjet nëse e bën më shpejt punë bankash nuk është kështu që kjo është një gjë e mirë për gjithë kush ka mundësi me e plotësuar është gjë e mirë.

Hekuran Xhani . Ne duam të sqarojmë interesin e qytetarëve për të bërë aplikimin .

Alime Hoxha . Meqenëse është diskutuar dhe në komisionin e ekonomisë një nga kushtet kryesore që ishte që të marrë përfitimin e kredisë më tha që personat që aplikojnë për këtë lloj kredie duhet të sigurojnë që kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar kredinë. Kriteri i parë ishte që personat që do aplikojnë për këtë kredi duhet të argumentojnë që kanë mundësi ta paguajnë pra kanë të ardhura për të paguar kredinë, ndërsa masa se sa mbulohet ishte gjithmonë në varësi të qytetit për Rrogozhinën aq sa janë tarift për Rrogozhinën në bazë të numrit të familjarëve çfarë mund të përfitojë duke qenë një çift i ri përfiton një dhomë një kuzhinë sa është çmimi për një dhomë e një kuzhinë në qytetin e Rrogozhinës pra me çmimet e referencës. Në bazë të numrit të familjarëve përfiton hyrje më të mëdha dhe gjithmonë çmimi është sipas referencës por një nga kushtet themelore ishte që duhet patjetër të kishit mundësi që të garantoni pagesën e kësaj kredie. Interesi ishte 3 % pastaj për vitet nuk ishjte e përcaktuar.

Mitat Daja . Sa është referenca për 1+1 këtu në Rrogozhinë?

Suela Proshka . Me thënë të drejtën unë nuk kam informacion për këtë ...

Mitat Daja . Po si do përcaktohet shuma. Sepse jam interesuar tek banka dhe një çift për një dhomë një+një, 26 milion japin. Blihet shtëpi me 26 milion?

Shpati Kolgega . Se po marrim shembullin e bashkisë Tiranë psh që e kishte nxjerrë thonte një + një, ishte 55 milion.

Indrit Dedej . Është standard tjetër ai këtu varet nga...

Shpati Kolgega . Pastaj thonte 2+1 kjo, familje me një person kjo shumë pra kush janë fashat...

Hekuran Xhani . Kush është interesi Shpat, se banka jep kredi sa të duash për të blerë shtëpi.



Shpati Kolgega . Ai merr sa të dojë me 3 %?

Hekuran Xhani . Bashkia Rrogozhinë deri në sa familje mund të aplikojnë?

Suela Proshka . Deri në 8 familje.

Hekuran Xhani . 8 familje përfitojnë nga ky grant.

Suela Proshka . Numri jepet nga institucionet përkatëse nga ministria për strehimin social dhe ministrai e financave.

Shpati Kolgega . Atëherë e kam kuptuar unë gabim subvencionon interesat e kredisë, bashkia nuk jep kredi. A ok e keqkuptova unë.

Indrit Dedej . Sa më shumë të vijnë aq më mirë është.

Mitat Daja . Unë mendoj sikur të ishte sistemuar pak ky lloj studimi tek pjesa e çmimeve, sepse çmimet që vendosen këtu në Rrogozhinë nuk janë faktike...

Edison Memolla . E ke me ligj me VKM.

Mitat Daja . Sepse tregu ka ndryshuar. Nëse ky ndryshim është bërë në 2019...

Edison Memolla . Se bëjmë ne e bën qeveria.

Mitat Daja . Në Tiranë 1+1 është bërë 65 mijë euro sepse tregu atje deri para një viti ka qenë 45 mijë 35 mijë euro sot është bërë 65.

Hekuran Xhani . Ka çmim referencë për atë Mitat, po ne tani mos e zgjasim se kemi edhe shumë pika tjera të rendit të ditës.

Mitat Daja . Tani o xha Hekri...

Hekuran Xhani . Unë e kuptova kështu Mitat si mik, 8 familje thotë fitojnë në bashkinë Rrogozhinë. Pra 8 familje e përfitojnë ishalla e fitojnë ata që janë më në nevojë por askush nuk ma do mendja t'i hyjë asaj pune.



Erind Tosku . Ti thua ta bëjmë sa Tirana...?

Mitat Daja . Jo nuk po them, thashë dhe njëherë tjetër një shtëpi tek pallati i ri që do bëhet këtu sa është metri katror?

Erind Tosku . Nuk e di.

Mitat Daja . 700 euro , 800 euro po e marrim një shembull 70 m² bëjnë 56 mijë euro.

Erind Tosku . Do marri referencën e zonës dhe ja sa do pronari i një pallati.

Sokol Gosa . Erindi kaloje.

Erind Tosku . E kalojmë në votim pikën 7, për projektvendimin... E hedhim në votim. Në rregull 14- janë pro. Një abstenim z. Mitat?

Mitat Daja . Kundër.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro, 1 (një) votë kundër (M.Daja), 0 (zero) vota abstenim pika 7 e rendit të ditës.

Vendim nr .60. Miratohet me 14-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5172/1.Prot datë 13.12.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin ‘Subvencionimi i interesave të kredisë’ “, si dhe Relacioni shpjegues për këtë projektvendim me Nr.5172/2.Prot datë 13.12.2024.

Lulzim Hasa . E njëjta abstenim me kundër.

Mitat Daja . Kundër se nuk është e plotë jo se jam kundër me procesin.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 8 Miratim i projekt - vendimit, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”. Ftojme drejtoreshën e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori, bashkë me drejtorin e financës z. Rezart Vogli, drejtorëve të tjerë do ja japim fjalën sipas çështjeve që mbulojnë. Në qoftë se ka ndonjë paqartësi apo ndonjë shtesë drejtorë kanë të drejtën të japin ... Znj. Marsida.

Marsida Thartori . Përhëndetje! Në vijim edhe të komisioneve që patëm ditën e Premte është



bërë Relacioni dhe Projektvendimi për Paketën Fiskale dhe janë ndryshuar sipas udhëzimeve që kanë ardhur nga Prefektura. E cila nuk do të quhet më Paketa Fiskale por sistemi i Taksave dhe Tarifave Vendore. Janë paraqitur të gjithë ndryshimet sipas propozimeve nga komisionet, propozimet nga dëgjesa publike dhe janë reflektuar tek drafti i paketës që ka ardhur për miratim. Nuk e di nëse keni ndonjë pyetje ndonjë paqartësi?

Alime Hoxha . Thjeshtë për informacion të gjithë ato që u thanë tek Paketa Fiskale të gjitha ndryshimet...

Marsida Thartori . Janë tek Relacioni.

Alime Hoxha . Janë tek relacioni dhe ishin të reflektuara, tani nuk e di nëse ka pyetje të tjera por ne si komision e verifikuam dhe ishin në rregull të reflektuara të gjitha ndryshimet që kemi propozuar.

Erind Tosku . Atëherë nga propozimet e komisioneve janë bërë ndryshimet tek dëgjesa e e të gjithë? Atëherë ndonjë pyetje për pikën 8-të?

Mitat Daja . Atëherë për taksat e tokës bujqësore shumica e njerëzve kanë ikur në emigracion dhe është një problematikë e taksave sepse normalisht Bashkia me taksa mbahet. Është menduar ndonjë mekanizëm se si të merret taksa sepse edhe shërbimet kanë kaluar online tani dhe nuk po e vret mendjen njeri të vijë tek Bashkia të marrë shërbim. Është menduar ndonjë mekanizëm për shfrytëzimin e këtyre sepse ato 10 vjetë 15 vjet nuk shfrytëzohen fare, as taksa nuk paguajnë por dhe njerëzit nuk përfitojnë nga ajo.

Marsida Thartori . Në mënyrë që të rrisim efikasitetin për vjeljen e taksave.

Mitat Daja . Po për taksat e tokës.

Marsida Thartori . Atëherë toka është pasuri e paluajtshme dhe si gjithë pasuritë e tjera të paluajtshme në bashkëpunim me drejtorinë e përgjithshme të pasurive të paluajtshme po mendohet që këto të kalojnë nga sistemi i e-albanias dmth do kalojnë për gjithë Shqipërinë jo më vetëm për bashkinë tonë. Ne na ka ardhur tani në Dhjetor një email që na kërkon dhe disa të dhëna të bashkisë dhe shpresojmë që nga viti 2025 të jenë në e-albania të gjithë taksat dhe faturat gjenerohen automatikisht nga e-albania. Ndërkohë nga ana tjetër bashkë me nënkryetarin dhe përgjegjësën e IT-së ne kemi pasur takime të vazhdueshme me Ujësjiellës Durrës dhe takime online me AKSHI-in që ne të kemi mundësinë që të kalojmë në agjent ekonomik për tarifën edhe



për këtë jemi në tratativa për ta realizuar nuk e di se sa do arrijmë ta realizojmë duke qenë se janë probleme teknike të sistemeve.

Mitat Daja . Tek zona turistike është përcaktuar ulja e taksës së ndërtimit kur ndërton Bashkia do kishte mundësi të përfitonte më tepër.

Edison Memolla . Po e njëjtë është si ka qenë.

Mitat Daja . Reduktohet në 30 % thotë.

Marsida Thartori . Përveç bregdetit, dmth çdo njësi administrative taksën e ndërtesës e ka 30 % më të ulët se Bashkia dhe bregdeti e ka njësoj si Bashkia përveç bregdetit.

Mitat Daja . Mua më duket këtu sikur keni bërë një ulje.

Edison Memolla . Ne aty presim.

Mitat Daja . Prandaj u habita dhe unë. Dhe unë ta kam thënë dhe njëherë Marsida tek shitjet online keni vënë një taksë që nuk është normale, ajo taksë e pastrimit ajo është online është një taksë që nuk ka kuptim.

Edison Memolla . Është vënë minimalja.

Marsida Thartori . Është tarifa më e ulët në gjithë bizneset është shitja online 10 mijë lekë.

Erind Tosku . Këtë pyetje e bëre dhe tek komisioni i ekonomisë kur ishte?

Mitat Daja . Nuk jam unë tek komisioni i ekonomisë.

Erind Tosku . Kur ishte. Kur kishe komisionin tënd e ke bërë këtë pyetje.

Mitat Daja . Kam dhe diçka tjetër Marsida përse i përket gjobave që vendosen unë e kam konstatim këtë thotë dënim për çarje ndotje rruge etj. Edhe vjet kam bërë të njëjtën gjë sepse kur e bën ndoshta ndonjë hallexhi i biem kokës kur e bën një Institucion është vendosur ndonjë gjobë sepse ujësjellësi sa herë i mbushet mendja na e prish xhaden e rrugën dhe na lë baltën po aty, i është vënë ndonjë herë gjobë këtij Institucioni?



Edison Memolla . Është me leje.

Mitat Daja . Po ai prish rrugën si me leje?

Edison Memolla . Kthehet në gjendje fillestare.

Mitat Daja . Është vendosur ndonjë gjobë nëse ska pasur leje?

Alime Hoxha . Tani ne jemi për të miratuar tarifat jo si mblidhen. Si mblidhen thirri ndonjë ditë tjetër ato në interpelancë i mbledhin apo nuk i mbledhin.

Mitat Daja . Po iki unë vazhdoni vetëm ju.

Alime Hoxha . Nuk do vazhdojmë vetëm ne, ne jemi për të miratuar tarifat. Nëse do pyesni se si mblidhen dhe sa mblidhen thirri në interpelancë ditë tjetër dhe bëje.

Mitat Daja . Është tek paketa Fiskale.

Alime Hoxha . Tek paketa fiskale është tarifa që paguhet jo si mblidhet.

Mitat Daja . Tani ma jepni me shkrim çfarë duhet të them dhe e bëj unë.

Alime Hoxha . Jo nuk ta japim me shkrim e ka rendi i ditës atë.

Mitat Daja . Ma jepni me shkrim çfarë duhet me thënë.

Alime Hoxha . Nuk ka nevojë për shkrim.

Erind Tosku . Z. Mitat mbarove pyetjen?

Shpati Kolgega . A mund ta bëj një pyetje shkurt. Tani këtu është një dokument shumë i gjatë doja të pyesja cilat tarifa kanë ndryshuar pra janë rritur ose ulur që ne të kuptojmë kush është ulur kush është rritur përveç atyre që janë të njëjta.

Marsida Thartori . Referuar relacionit është i pari fare janë bërë ndryshime tek tarifa e pastrimit për disa kategori biznesi dhe është bërë dhe tarifa e ujitjes vaditjes...



Marsida Thartori . Nga komisioni i ekonomise i kemi diskutuar.

Shpati Kolgega . Sugjerimi im është të ketë të paktën për biznesin e vogël ushqimoret minimarketet nëse doni të ja ulni biznesit të madh ok edhe kjo nuk duket e arsyeshme sepse shumta është dyfish apo trefish në disa raste...

Marsida Thartori . Jo jo 500, 600 ; 150 , 200 është tek ndotja që bëjnë në pazar.

Shpati Kolgega . Tani varet si e përcakton ndotjen e përcakton në sasi apo në ...se ti mund të hedhësh dhe një bidon vaj dhe ndot shumë më shumë se 100 kartona që hedh një... Ne për supermarketet po e ulim pak.

Marsida Thartori . Jo supermarketet nga 50 në 60.

Shpati Kolgega . Kryetar në qoftë se mundem propozoj që ushqimoret minimarketet të paktën të ja lejmë të njëjta mos të ja rrisim.

Marsida Thartori . Jo jo nga 150, 200 dhe janë ulur artikujt industrial argjendaritë parfumeritë. Sepse nuk bën argjendaria parfumeria një ndotje sa minimarketi ç'është e vërteta. Artikujt industrialë që i shet po me kuti nuk është se i shet tek e tek prandaj, kjo është parë diferenca.

Hekuran Xhani . 500 mijë lekë në vit?

Marsida Thartori . Jo jo 50 mijë lekë në vit.

Indrit Dedej . 500 mijë lekë çfarë do bëjë ai.

Altin Tosku . Berbehanja sa është shumta?

Marsida Thartori . Profesionet e lira janë bërë të gjitha 120 mijë lekë, kanë qenë 150 ndërkohë që parukeria ishte 100 dhe i futëm në një kategori, i futëm si profesione të lira edhe një që mund të jetë një ekonomist në një zyrë të vogël.

Shpati Kolgega . Duhet parë dhe pjesa t'i ndihmojmë pak se një pjesë e madhe kam përshtypjen mezi mbijetojnë dhe janë biznese familjare nuk është se janë biznese...

Hekuran Xhani . Në mbështetje të diskutimit të Shpatit duhet me i ardhur ne ndihmë biznesit



se biznesi atë tarifë që ne e rrisim e gjithë kjo vlerë e vogël po prap kjo shkon në kurriz të konsumatorit pra në kurriz të qytetarit pra unë mendoj të ngeli në tarifën ku ishte.

Indrit Dedej . Tani unë atë dua zonja drejtoreshë të mbash shënim, shyqyr që doli një.

Edison Memolla . Tani të gjitha këto janë reflektuar të gjitha dhe nga dëgjesa publike...

Marsida Thartori . Të gjitha propozimet janë marrë parasysh kanë ardhur me shkresë.

Edison Memolla . Nuk kemi qenë kundra asnjëherë që t'i vijmë në ndihmë bizneseve të reja apo të vjetra të mëdha apo të vogla, jemi dashamirës të bizneseve mirë se të vijnë në qytetin tonë dhe do jemi dhe ndihmëtarë gjatë gjithë periudhës së tyre dua që t'i shkojmë sa më për shtat se normalisht pa taksa nuk mbahet.

Altin Tosku . Atëherë minimarketeve sa i bëhet ushqimoreve?

Marsida Thartori . 20.

Altin Tosku . 200, ishte .

Marsida Thartori . Jo ishte 150 i shkon 200.

Altin Tosku . Se kur futesh në një dyqan të vogël që është 2 me dy në mes të lagjes atëherë si mund ta futësh ti këtë 200 mijë lekë se quhet minimarket.

Hekuran Xhani . Faktikisht vlera është shumë e vogël, se 60 mijë lekë të vjetra në vit është megjithatë...

Altin Tosku . E ke dëgjuar ti që mbledh lapsi xha Hekri...

Hekuran Xhani . E di xhaji e di.

Shpati Kolgega . Të gjithë rriten nga pak, pak ajo pak ajo.

Marsida Thartori . Por edhe kostoja për atë pastrimin që i bëhet nuk e mbulon sepse me atë tarifën që ai paguan nuk e mbulon koston.



Indrit Dedej . Ne po flasim për një dyqan në fshat që atje ti nuk bën asnjë lloj pastrimi fare po ta kapësh nga pastrimi flasim për një dyqan në fshat.

Marsida Thartori . Ku në fshat?

Indrit Dedej . Kudo që të jetë.

Marsida Thartori . Në fshat ne mund të kemi dhe subjekt informal që nuk ka NIPD fare.

Indrit Dedej . Aty është detyrë e jotja ajo.

Marsida Thartori . Ok është detyra ime unë e kuptoj por që ai mund edhe të mos paguaj fare.

Hekuran Xhani . Aty tek paketa nuk specifikohet...?

Marsida Thartori . Është e ndarë sipas xhiros ato që janë biznes i vogël e kanë 200 mijë lekë ato që janë biznes i madh 600 është sipas xhiros që deklarojnë tek tatimet.

Altin Tosku . Unë tek tarifa minimarketeve do isha të rritet 250, madje janë disa biznese nuk janë futur fare në listë. Biznese që janë të peregjistruara ju nuk i keni futur akoma në listë...

Edison Memolla . Si?

Altin Tosku . Biznese që janë të peregjistruara ju nuk i keni futur akoma në listë.

Hekuran Xhani . Ore mendimin do ta ulim...?

Erind Tosku . Edhe dëgjesa është bërë edhe komisioni ekonomik është bërë.

Altin Tosku . Ku ke bërë dëgjesë ti?

Erind Tosku . Po tek kinemaja është bërë.

Alime Hoxha . Ne i kemi diskutuar disa herë dhe ishim dakord për këto tarifa nëse ju keni propozime për tarifa tjera është e drejta juaj por ne si komision i morëm parasysh edhe ato.

Shpati Kolgega . Çfarë problemi ka në qoftë se ndryshohet? Unë psh kam këtë autoshkollat agjensitë nuk kemi pse ja ulim.



Marsida Thartori . Edhe autoshkollat edhe agjensitë këto kanë ardhur dmth janë në një kategori dhe ulja për këto ka ardhur nga dëgjesa publike propozim.

Shpati Kolgega . E dini ju psh sa është rritur tarifa autoshkollave për të marrë një patentë?

Indrit Dedej . Kush e propozoi?

Marsida Thartori . Ka ardhur nga biznesi, janë me shkresë.

Indrit Dedej . Kush qenë biznes atë ditë në dëgjese publike?

Marsida Thartori . Kanë ardhur me shkresë Visi i ka shkresat.

Edison Memolla . Ishit ju që propozuat.

Indrit Dedej . Unë tek kjo pjesë nuk jam kundra por a mundet me u bërë a nuk mundet?

Edison Memolla . Ne kemi qenë mos them 100 % të gjithë ankesave shkresave të gjithë dëgjesave i kemi reflektuar aty, pa asnjë lloj.

Indrit Dedej . Unë personalisht si anëtar i komisionit të ekonomisë kam rënë dakord nuk tërhiqem mbrapsht.

Shpati Kolgega . Pra unë jam që kjo mos rritet dhe kjo të paktën të rrijë siç janë edhe agjensitë edhe autoshkollat.

Edison Memolla . Ne e kalojmë dhe propozoj që në Janar të bëjmë ndryshimet që keni ju.

Altin Tosku . Të bëjmë rishikim taksash.

Edison Memolla . Rishikim taksash.

Shpati Kolgega . Pra që këto të mos futen në fuqi, pra mos ti paguajnë bizneset.

Edison Memolla . Mbledhjen e ardhshme i shikojmë këto pika që ju propozoni.

Silvana Aliu . Edhe buxhetin do ta kalosh në Janar?



Edison Memolla . Jo ta kalojmë dhe do ta rishikojmë, rishikim i ktyre zërave.

Shpati Kolgega . Ok me premtimin që do ta bëjmë në Janar ok.

Indrit Dedej . Ishalla të na vish sa më shpejt se ti doktori hajt më se ka pak më shumë probleme me të sëmurit por ti...

Shpati Kolgega . Paskeni qenë dhe në dëgjesë publike dhe prap...

Indrit Dedej . Nuk na dëgjoji njeri, ne plasëm por...

Marsida Thartori . Jo jo, janë marrë të gjitha propozimet.

Alime Hoxha . Atëherë tarifat janë vendosur siç e tha dhe Marsida, na është argumentuar në bazë të mbetjeve që ato prodhojnë për t'i depozituar tek koshat dhe këto tarifa i kemi pranuar të tilla për këto arsye.

Erind Tosku . Atëherë hedhim në votim pikën 8 të rendit të ditës. Po e hedhim në votim. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 8 (tetë) e rendit të ditës.

Vendim nr. 61 . Miratohet me 15 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë, me shkresën Nr.4486/2.Prot, datë 18.12.2024 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Rrogozhinë viti 2025”.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 9-të rendit të ditës “Shqyrtim dhe miratim i realizimit faktik të buxhetit të vitit 2024 të bashkisë Rrogozhinë”. Relaton drejtori i financës z. Rezart Vogli.

Edison Memolla . Atëherë paraprakisht po e marr unë pak fjalën tek buxheti faktik. Realisht gjatë këtyre viteve nuk po e marr vetëm këtë vit që kemi qenë në drejtim të bashkisë jemi munduar që të ulim sado pak borxhin e viteve paraardhës që e kemi trashëguar. Kemi bërë një punë goxha të mirë që duhet ta vazhdojmë akoma edhe gjatë këtij viti që na vjen edhe gjatë vitit që do vijë pas. Dhe investimet kanë qenë të reduktuara më shumë në shërbime meremetime shërbime të nevojshme pa hyrë në investime të mëdhaja, kanë qenë investime të vogla. Ka qenë realizimi i riparimeve të objekteve të shkolave të objekteve të infrastrukturës rrugëve, ka qenë



sistemimi i të gjithë shkollave që kanë pasur nevojë në bazë dhe të kërkesave. Kemi pasur investime më shumë nga ana e shtetit që kanë qenë fasadat e qytetit kanë qenë rrugët me asfalt që janë shtruar rruga e Spillesë që thuhet është në përfundim. Kemi qenë më shumë tek investimet e shtetit dhe buxheti i bashkisë, shkoj drejt shlyerjes së detyrimeve siç e parashikuam edhe në fillim erdhi një shtesë për bashkinë tonë që dhe ajo do shkojë po për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Kështu që shpresojmë që viti i ardhshëm të jetë akoma më i mirë se ne po punojmë shumë tek pjesa e bregdetit që duam ta kthejmë atë në zonë turistike sepse dhe të ardhurat më të mëdhaja Bashkia jonë i merr nga ana e turizmit, siç janë beach bar-et apo siç janë pjesa e rërës që merret në përdorim. Duam që zona atje të kthehet jo të bëhet katrahurë siç janë bërë disa zona por të ndërtohet në mënyrë të rregullt dhe me një filozofi të mirëfilltë të një turizmi elitari. Kemi bashkëpunim me qeverinë presim që atje të ndodhin vitin e ardhshëm ujërat e zeza, ndryshimi i elektricitetit që të ketë ngritje fuqie dhe ujësjellësi që është në projekt e sipër sepse do parë dhe zona sepse duhet dhe uji që të jetë i pijshëm. Ato burime që kemi bërë nuk e përballojnë dot pjesën e gjithë turizmit sepse gjatë verës do arrijnë deri në 20 mijë turistë në ditë. Prandaj këto janë ato që janë bërë pak a shumë kryesoret për vitin e ardhshëm do e shikoni tek buxheti kemi futur disa do e shikoni por ndër këto ne mendojmë që të realizohet edhe nga ankesat e shumta që kemi pasur nga lagjja mbas bashkisë që fillon nga kinemaja dhe përfundon lagjja nr.1, dhe përfundon tek rruga e burgut. Është bërë një projekt nga ana e jonë, ka qenë projekti është riparë dhe njëherë nga e para sepse ujërat e zeza janë problematikë shumë e madhe aty bëhet fjalë që të bëhet komplet investimi nëntokësor ujërat e zeza edhe ujërat e bardha dhe ndriçimi dhe asfaltimi. Ky është buxhet që është menduar që të ketë 2-3 vite shlyerje të këtij investimi edhe kjo do shikohet në bazë dhe të ardhurave që do shikojmë dhe do ketë vitin e ardhshëm. Për më shumë detaje do flasë edhe drejtori për shifra edhe të tjera unë jam i gatshëm që t'i përgjigjem pyetjeve të juaja për çdo paqartësi edhe për çdo ankesë që mund të keni.

Indrit Dedej . O kryetar i këshillit t'i bëjmë një pyetje kryetarit, se kryetari me fjalë është mjaltë, ne e shohim në terren popull, kurse kryetari e sheh se ja ka lënë detyrat këtyre “Shkoi Kola në shtëpi, shkoi”. Ti në radhë të parë njëherë pasqyra e bashkisë është kryetari i bashkisë 4 administratorët unë këtu që të shoh buxhet me karrige bosh vetëm tek kjo bashki ndodh.

Edison Memolla . Ku i sheh karriget bosh ti?

Indrit Dedej . Sepse ti nuk ke, katër shtyllat tuaj janë kryetarët administrativ.

Edison Memolla . Ku është pyetja?

Indrit Dedej . Ja pra kjo është pyetja.



Edison Memolla . Janë mbaruar ato punë është puna juaj sot nuk është e administratorëve.

Indrit Dedej . Së dyti ti nuk ke një tabelë transparence për qytetarët ...

Edison Memolla . Që do të thotë ?

Indrit Dedej . Sepse bën investime dhe investimet i mban nën sirtar.

Edison Memolla . Atëherë këtë e ke gabim se e ke online, çdo investim që bëhet e ke ta jap unë.

Indrit Dedej . Shumë mirë ti online i nxjerr mbas kur të ju dojë qejfi, ti e ke të përcaktuar me ligj që çdo investim çdo punë publike ti duhet ta shpallësh ku e di unë se bashkia nuk ka asnjë lloj zyre asnjë lloj.

Edison Memolla . Ta hap unë online tani? Ma jep telefonin ta hap unë tani.

Indrit Dedej . Shiko unë jam me syze unë qërrohem nuk e shoh dot.

Edison Memolla . Po çfarë të bëj unë paske probleme syzesh nuk paske problem...

Indrit Dedej . E ke për detyrë ligjore që të bësh tabela që të informosh publikun nuk i ke?

Edison Memolla . I kam.

Indrit Dedej . Po si ke pra.

Edison Memolla . Po ti thua kam syze nuk i shoh çfarë të them unë.

Indrit Dedej . Po nuk ke tabela atje aunë kam shkuar kam kontrolluar nuk kam gjetur.

Edison Memolla . E ke çdo gjë online nuk bëhen tabela me letra më.

Indrit Dedej . Zyrë tjetër më se nuk është as ai kush i lëshon vërtetimet këtu, as zyrë vërtetimesh nuk ke ti.

Edison Memolla . Ku është pyetja se nuk po e kuptoj.



Indrit Dedej . Se kam ankesë nga qytetarët prandaj po them.

Edison Memolla . Për çfarë nuk lëshohet vërtetimi?

Indrit Dedej . Vërtetim që ka mbaruar ushtrinë.

Edison Memolla . Ka mbaruar ushtrinë?

Indrit Dedej . Vërtetim që është banor i lagjes.

Edison Memolla . Ta jep kryeplaku.

Indrit Dedej . Nuk ta jep kryeplaku se ta jep .

Hekuran Xhani . Ta jep administratori.

Edison Memolla . Ti e ke që nuk pasqyrohen veprimet, një ke faqen e bashkisë që e ke një nga më të azhornuarat ndoshta në Shqipëri.

Indrit Dedej . Tek faqja e bashkisë del vetëm Edisoni me ca kalamaj.

Edison Memolla . Ke faqen e tenderimeve që bëhet çdo tender , tenderimet e bashkisë Rrogozhinë i ke online për çdo gjë që ndodh edhe çdo transfertë që bëhet çdo pagesë që bëhet e ke tek thesari, i ke të gjitha online.

Indrit Dedej . Kryetar ne të kemi bërë disa kërkesa sepse edhe sekretari nuk na i ka marrë përsipër ne që t'i bënte vetë kërkesat t'i sillte tek ti...

Edison Memolla . Tani po ta bëjmë bisedë kështu unë po të jap prgjigje...

Indrit Dedej . I kemi bërë ligjërisht kërkesa nuk na ka ardhur asnjë lloj informacioni si këshilltar jo si qytetar, si qytetar si begenis fare ti.

Edison Memolla . Atë e thua ti, se cakton njeri tregojnë rezultatet se cakton ti atë punë.

Indrit Dedej . Shkon tek shefi i financave thotë nuk don kryetari, unë jam prezent.



Rezart Vogli . Nuk është e vërtetë muk ke ardhur asnjëherë.

Edison Memolla . Kë të besoj ty apo ?

Indrit Dedej . Do besosh anëtarët e këshillit se të ka sjellë letrën aty.

Edison Memolla . Bëj pyetjen çfarë ke.

Erind Tosku . Bëj pyetjen se ka dhe këshilltarë të tjerë Mitati.

Indrit Dedej . Po vazhdo e lashë. Buxhet metre faqe ja.

Altin Tosku . Unë do isha për një treg, se ka qytetarë që si është shi si është diell... treg qyteti jo treg ... Duhet të marrësh vetë tregtarët që janë e konstaton dhe e bën...

Edison Memolla . Është menduar është futur në buxhet një treg po themi i lëvizshëm nga ato me tenda të mbuluara siç duhet edhe do vendoset aty ku duhet sepse gjithë problem ne e dimë shumë mirë që e kanë se nuk hyjnë tek tregu tjetër se ne kemi tregun e mbyllur aty. Kemi menduar dhe në buxhet është futur të bëhet me tenda siç janë në Tiranë ato tregjet siç janë të mbuluara me teza çdo gjë të jetë brenda normave dhe mos shesin në rrugë.

Mitat Daja . Gjithë ai shi ku do shkojë qytetari ose kur është diell?

Altin Tosku . Qytetari nuk do se opsioni i është dhënë që të hyjë tek tregu i vjetër por nuk don. Nuk duan të hyjnë se kemi bërë mbledhje me të gjithë tregtarët nuk duam të hyjmë aty brenda.

Mitat Daja . Aty është pak i mbyllur nuk ka...

Edison Memolla . Është menduar opsioni tjetër tani hajde bashkërisht ku do ta lejmë. Është bërë nuk e di se sa teza për 20 apo 30 tregtarë që janë të përhershëm që janë parë aty, të vendosen këto të mbuluara që të mos kapi as shiu as dielli me tendë dhe të jenë me pjesë të larta me sirtarët e vet, kështu që është parashikuar në buxhet është e drejtë ajo që ngrëjti Altin.

Mitat Daja . Tani unë kam lexuar dhe buxhetin e faktik dhe është folur për uljen e borxhit 12% është ulur borxhi tek buxheti i këtij viti që lam pas. Pyetja është borxhi është ulur për shkak të arkëtimit të përmirësimit të të ardhurave apo janë ulur investimet në këtë rast? Dhe pyetja e dytë



kjo ishte paranteza është që a ka ndonjë plan për likuidim borxhi ndaj palëve të treta apo thjesht kush përplas këmbët më tepër ai i merr lekët më parë? Këto dy pyetje kam.

Edison Memolla . Atëherë për pjesën e borxhit që e kemi ulur 12% janë mirëmenaxhimi i të ardhurave që thotë Indriti që nuk keni ashtu dhe është pjesa e rritjes së të ardhurave nga taksat.

Mitat Daja . Nuk janë bërë investime?

Edison Memolla . Ato që janë bërë investime janë bërë ato që duhen me u bërë nuk janë bërë investime të mëdhaja.

Mitat Daja . Ka pasur investime të perealizuara këtë vit për shkak sepse...?

Edison Memolla . Një nga realizimet ka qenë po flasim prap për lagjen e juaj ka qenë planifikuar për tu bërë për në 4 vjet nuk u bë vjet për arsye sepse të ardhurat nuk premtuan kështu që kjo është perealizimi është transferuar për këtë vitin që vjen.

Mitat Daja . Sa është borxhi total i bashkisë?

Edison Memolla . Ka qenë rreth 2.6 miliard ose 2.6 milion euro, sot që flasim është diku tek 800 apo 900 milion lekë të vjetra.

Mitat Daja . Pra është ulur goxha borxhi?

Edison Memolla . Po, çdo vit jemi ulur.

Mitat Daja . Ka një plan për këtë larjen...?

Edison Memolla . Ka plan por përparësia janë më të vjetrit që janë dhe ato që kanë më shumë. Sepse e kemi edhe ligjërisht sepse nuk mund të marrë një i vjetër që ka, se flasim që ka kanë borxhe dhe nga komunat në 2013 nuk flasim vetëm për këtë. Dhe merren ato dhe duke ardhur duke u duke u ngjitur...

Mitat Daja . A miratohet nga Bashkia?

Edison Memolla . Është nga Ministria e Financës dhe nga ana juaj që e keni miratuar se si duhet të funksionojë.



Hekuran Xhani . Lidhur me grumbullimin e prodhimeve bujqësore sepse Bashkia jonë për fat sektori i bujqësisë ngel ndër sektorët më të rëndësishëm ku prodhuesit tanë nuk kanë asnjë pikë grumbullimi ku do të grumbullohen prodhimet bujqësore dhe të tregtohen psh unë shoh Bashkia Lushnje e ka, Bashkia Divjakë e ka dhe në bashkëpunim me AZHBR-në apo ministrinë e bujqësisë ku dhe Bashkia të ketë aksionet e veta ne ti afrojmë fermerit të bashkisë tonë një vend ku t'i mundësojmë grumbullimin dhe shitjen e prodhimit bujqësor, këtë e kam sugjerim të kryetarit brenda mundësisë...

Edison Memolla . E kemi ndjekur dhe është përcaktuar deri diku një vend por nuk kemi gjetur sepse në bashkëpunim duhen edhe fermerët të jenë pjesëtarë të kësaj gjëje, qeveria ka nxjerrë një fond të deleguar për këtë pjesë kemi shkuar dhe ka qenë pjesa në Gërmej ish repartit ku janë ato tunelet aty poshtë kemi bërë dhe shkresa në Ministrinë e Mbrojtjes që ajo pronë të kalojë tek ne dhe të kemi sa më pak që ajo zonë meqë është Gërmeji aty po themi nyja kryesore e kësaj gjëje por na duhet bashkëpunim i të gjithëve që të hyjmë ne hyjmë pjesëtarë edhe fermeri hyn pjesëtarë.

Hekuran Xhani . Kjo është faktikisht taman ashtu siç e ka ndërtuar perëndimi kjo metodë.

Edison Memolla . Nuk kemi gjetur dakordësi.

Hekuran Xhani . Por ka një problem tani lidhur me vendin Gërmej, themi që duhet zgjedhur një pikë, buzë autostradës në fund të fundit me qera buzë autostradës ku t'i japë mundësi dhe Kryevidhit pra në qendër të bashkisë ku i bie mesi ti japi mundësi edhe komunës Kryevidh edhe komunës Sinaballaj si dy pika më të largëta të Bashkisë që fermerët pothuajse të jenë të barazlanguar për të sjellë prodhimet e veta. Gërmeji është shumë mirë si vend për frutat...

Edison Memolla . Meqë ka dhe dalje aty sepse autostrata ka dalje prandaj është menduar ajo pjesë sepse nga ana e Kavajës... Kjo nuk është vendosur...

Hekuran Xhani . Kjo punë le të ngelet ndër prioritetet për 2025 nga bashkia që t'i vijmë në ndihmë edhe atyre prodhuesve që na kanë ngelur.

Silvana Aliu . Për tregun nuk mund të vendoset sheshi që është tek stacioni i trenit?

Edison Memolla . Puna është se ku do përcaktohen nuk është puna nga ana jonë ne vendosim por është problemi i tregtarëve ne e çojmë tek stacioni ato do dalin të shesin me tezgja mes pallatit. Kjo është puna që ti gjejmë dhe atyre një pozicion që të jenë sa më afër qendrës komunitetit.



Hekuran Xhani . Nëse bëhet tregu janë të detyruar të shkojnë në treg ato.

Erind Tosku . Po z. Enver kishit pyetje?

Enver Memolla . Faleminderit z. Kryetar, si rrallë herë po marr fjalën shumë pak sot, kam një pyetje për Kryetarin e Bashkisë dhe drejtorinë e Financave në projektbuxhetin e vitit 2024... Ka kuorum?

Erind Tosku . Për momentin nuk kemi, bëjmë një pushim 5 minuta dhe fillojmë direkt me pjesën e asaj.

-Pas pushimit 10 min rifillon mbledhja.

Erind Tosku . Pas pushimit vazhdojmë me pyetjet që kishte z. Enver për kryetarin e bashkisë.

Enver Memolla . Atëherë si fillova pak më parë pyetjen dhe për financën dhe për kryetarin e bashkisë, meqë jemi tek buxheti faktik. Në radhë të parë jeni me vonesë por një pyetje kam mesa mbaj mend në buxhetin e 2024 është miratuar në Dhjetor të 2023 është miratuar një fond prej 6 milion lekë të reja për rivitalizimin e rrugës së malësisë në Njësinë Administrative Sinaballaj dhe nga biseda bë buxhet në komisionin e ekonomisë ka ndodhur që nuk është bërë ky investim dhe ka kaluar prap për parashikim në buxhetin e 2025. A mund ta di se cila ka qenë pengesa që nuk është bërë investimi nga Dhjetori në Dhjetor?

Edison Memolla . E kthej unë përgjigjen. Mbarove ke tjetër? Ky investim ka nisur herët faktikisht u relatua projekti vendi, ku do ndërhyhet si do ndërhyhet me aq buxhet sa ne kishim, kjo praktikë ka nisur rreth muajit Shtator realisht me u hedhur në sistem është hedhur ka pasur problematika dhe ankesa kur bëhet tenderimi se nuk e ndalojmë dot që të ketë, realisht ka dalë fituesi i asaj është parë dhe terreni, pritet nënshkrimi i kontratës që të vazhdojmë pjesën e punës. Ai fond është i përcaktuar dhe do zhvillohet ka qenë për tu bërë për këtë vit por nuk besoj që të realizohet sepse edhe nëse punimet nisin sot nuk i mbaron dot për 10 ditë sepse koha nuk na premtton. Ky fond trashëgohet i këtij viti shkon prap për këtë pjesë. Ka qenë problematika që nuk është mbyllur në kohë për punë procedurash jo për faj ...

Enver Memolla . Procedura në Shtator ka nisur.

Edison Memolla . Ka nisur por ka pasur problematika ankesa është rikthyer është anuluar disa gjëra që janë teknike.



Enver Memolla . Kur ka nisur procedura sepse miratimi është bërë.

Edison Memolla . Procedura ka nisur nga muaji Shtator nëse nuk gaboj.

Enver Memolla . Se nëse nuk ke pasur fonde kur e ke miratuar në Dhjetor dhe fillon procedimi në Shtator normalisht do ndodhi pjesa e këtyre handikapëve ligjorë me ankesa pa ankesa sepse marr shkas se do jenë disa parashikime tjera dhe do jetë e njëjta situatë...

Edison Memolla . Shpresojmë mos jetë e njëjta situatë, se këto janë mësimë që ne nxjerrim.

Enver Memolla . Jeni shprehur që dhe investimi do bëhet brenda vitit.

Edison Memolla . Ky investim duhet të ishte bërë para se t'u vilnin ullinj të kjo ishte parashikuar nga teknike e jona nuk u arrit dot jo vetëm për fajin tonë por edhe për faj të gjërave që janë në mes sepse gjëra teknike që nuk mund të thuhet të gjitha këtu.

Enver Memolla . Tani i bie që ose nuk ka pasur fond ose...

Edison Memolla . Fondi ka qenë aty dhe është aty.

Enver Memolla . Është i pamjaftueshëm si fond.

Edison Memolla . Për ta bërë si duhet normalisht që është i pamjaftueshëm.

Enver Memolla . Atëherë ke të drejtë prap që të rishikosh fond, të rishikosh dhe vendimet. Ta kesh parasysh dhe për vitin në vazhdim që këshilli bashkiak ka të drejtë që ta rishikojë buxhetin në bazë të ...

Edison Memolla . Tani ne e kemi dërguar kemi parë dhe rrugën atje të paktën për ato maloret kush ka qenë atje sipër e di shumë mirë që bëhet rërë botuminoze, të shikojmë se si do shkojë me aq buxhet sa kemi edhe nëse do ketë nevojë për shtesë mbledhjen e ardhshme siç ne folëm mund ta rishikojmë sërish këtë pjesë. Nuk ka lidhje buxheti është punë procedurale nuk ka lidhje buxheti.

Erind Tosku . Ndonjë pyetje tjetër për realizimin e buxhetit faktik 2024? Ndonjë paqartësi? Ok, e hedhim në votim pikën nr.9. E hedhim në votim. Po, të gjithë pro miratohet.



-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim pika 9 e rendit të ditës.

Vendim nr .62. Miratohet me 11-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim, me shkresën Nr.5247. Prot, datë 18.12.2024 “Mbi realizimin faktik të buxhetit 2024”.

Erind Tosku . Atëherë kalojmë në pikën 10, “Shqyrtim dhe miratim i Relacionit të Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Rrogozhinë”. Drejtori i Financës z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Atëherë përshëndetje të gjithëve! Në vitin 2024 Ministria e Financave në bashkëpunim me projektin Bashkitë e Forta ka mundësuar që PBA dokumenti i buxhetit afatmesëm për bashkinë Rrogozhinë viti 2025 të plotësohet online në faqen e Ministrisë së Financave. Bashkia Rrogozhinë ka filluar punën që në fillim të vitit ka mbyllur dy fazat e para që janë faza një dhe faza dy duke plotësuar tavanet buxhetore duke përcaktuar ekipet për secilin program, ka përcaktuar disa objektiva afatmesme për tre vitet në vazhdim. Një objektiv e paracitoi kryetari që është rivitalizimi i lagjes nr.1 që është blloku i ndërtesave mbrapa gjimnazit, investim i parashikuar në masën 120 milion lekë por duke parë dhe planin e shpenzimeve të bashkisë Rrogozhinë e cila nuk e mbulon dot një likuidim të një investimi të tillë brenda një viti është parashikuar dhe është menduar është hedhur në buxhetin afatmesëm për tre vite që të ketë likuiditetin për tre vite. Tjetër parashikim që ka bashkia Rrogozhinë për vitin 2025 - 2026 - 2027 është stafi i MZSH-së, duke qenë që stafi i MZSH-së ka në pronësi të vet në përdorim një zjarrfikëse e cila është shumë e amortizuar është menduar që ashtu si viti që lam pas buxheti i shtetit na akordoi një fond për emergjencat civile të cilin ne e përdorëm në masën 93 % për të bërë të mundur blerjen e një eskavatori me zinxhir për pjesën e bujqësisë edhe këtë vitin që jemi aktualisht nuk e kemi parashikuar këtë fond në buxhetin e vitit por e kemi parashikuar për buxhetin afatmesëm tre vjeçar me qëllim në momentin që këto fonde na është premtuar dhe na është thënë që do vijnë sërish në bashki të Rrogozhinës këto fonde t'i përdorim për stacionin e MZSH-së t'i vijmë në ndihmë atyre. Për sa i përket ujitjes dhe kullimit e thamë që i kemi bërë të mundur blerjen e një eskavatori me zinxhirë nga kërkesa dhe nga diskutimi që kemi pasur me drejtorin dhe zyrën e bujqësisë është e nevojshme që këtij skepi t'i vihet në ndihmë me karburant për pjesën e mbetur dhe që kështu për PBA 2025-2027 është menduar që të ketë një volum të rritjes së karburantit për pjesën e bujqësisë për sa i përket arsimit parashkollor kërkesat nga ana e drejtorisë së arsimit kanë qenë për mjetet didaktikore për arsimin parashkollor për fëmijët e kopshteve dhe çerdheve , ka pasur kërkesë dhe është parashikuar për ndërhyrje në infrastrukturë për ndarje ambientesh ndërmjet shkollave dhe kopshteve me qëllim që fëmijët e kopshteve dhe çerdheve të jenë të ndarë kur hyjnë në ambientet e shkollës. Kemi një kërkesë nga



senati i gjimnazit “Haxhi Qehaj” për nxënësit e senatit të cilët kanë aktivitete kulturore dhe sociale aktivitete të tjera gjatë vitit që të kemi parasysh dhe të buxhetojmë dhe kërkesat e pjesës së gjimnazit ndoshta nuk do e arrijmë në masën 100% vitin e parë duke parë që dhe diskutimi u bë në një afat në limitet e kohës kemi menduar që për arsimin e mesëm për nxënësit e shkollave këtu duhet të fus krahas nxënësve të shkollës të gjimnazit Rrogozhinë kemi propozuar që gjimnazi i nxënësve në Gosë edhe ato të bëjnë kërkesat e tyre me qëllim që Bashkia Rrogozhinë t’i vijë në ndihmë edhe nxënësve të gjimnazit të Rrogozhinës për aktivitetet e tyre që kanë sociale kulturore sportive gjatë vitit. Për pjesën e ujitjes doja t’u ktheja pak ...

Sokol Gosa . Më fal meqë je tek gjimnazet edhe për terrenet sportive, mbajtja, rregullimi sistemimi shtrimi me bar artificial.

Rezart Vogli . Po profesor ke të drejtë i bëra një përshkrim pak të shkurtër ndoshta nuk e ceka dhe atë. Për pjesën e objekteve arsimore, se për pjesën e terreneve sportive ashtu siç kemi diskutuar edhe bashkë me komisionin është marrë në shqyrtim dhe është diskutuar dhe është para parë që edhe për pjesën e ambienteve të jashtme të shkollave dhe gjimnazeve të ketë një rishikim dhe një rivitalizim të këtyre hapësirave. Duke parë mundësitë tona nuk mund të themi një shifër një vlerë një gjë konkrete se duhet të shohim dhe planin duhet të bëjmë dhe një studim të terreneve ne parë se çfarë nevojash specifike dhe çfarë nevojash emergjente kanë objektet arsimore. Këto janë disa nga parashikimet që ka Bashkia Rrogozhinë për të ardhmen, ne aktualisht jemi në zbatim krahas atij investimi që u parashtrua pak më parë nga z. Enver që është pjesa e rrugës së malësisë, kemi dhe një investim tjetër që është prap në proces zbatimi ai është një projekt i kaluar në këshill bashkiak për shtresat për familjet në nevojë. Është një projekt i fituar nga ana e bashkisë Rrogozhinë është akorduar fondi nga ana e Ministrisë së Financave por për shkaqe teknike siç e citoi dhe kryetari nuk është zbatuar akoma dhe është në proces zbatimi. Pak a shumë këto janë parashikimet që ka.

Sokol Gosa . Ne këtë vit miratuar rritjen e pagave për administratën. Një pyetje kam po për këto punonjës po të bashkisë tonë policët e bashkisë, sekretarët nëpër shkolla a ka ndonjë hapësirë ligjore që edhe për këto bashkia mund të ketë rritje apo duhet vetëm me vendim? Ose thjeshtë këto të Tranës Durrësit a ka hapësira dmth për një rritje se ne e miratuar u rritën vetëm drejtorave? Duhet shikuar dhe paga e këtyre në Janar.

Edison Memolla . Kjo është një problematikë që e kemi të gjithë bashkitë sepse ne jemi në maksimum tek paga e këtyre presim që të dalë një vendim një ligj i ri për pjesën për shofer, topograf i mesëm, se nuk janë vetëm këto punonjësit e shërbimeve janë shumë kategori pastrimi që nuk janë prekur realisht dhe ka ngelur tek pjesa e ulët. Presim që të dalë një vendim i ri i



qeverisë që edhe këto të ripreken si policia bashkiake apo ndoshta dhe disa zëra të rinj. Ne jemi në maksimumin e asaj që na lejon ligji, jemi dashamirës po pritet që të dalë normalisht që do dali edhe veprojmë edhe për këto shtresa sepse një eskavatorist realisht merr një pagë që nuk quhet pagë. Marrim këto që janë elektrikist, hidraulik nuk vjen nje ri me këto kështu që pritet një vendim që të na vijë në ndihmë që ti shkojmë në ndihmë këtyre punonjësve që kemi.

Mitat Daja . Siç e përmendi dhe Rezi për punën e strehimit edhe vjet në Janar u miratua ...

Rezart Vogli . Në Shkurt.

Mitat Daja . Dakord në 2024 u miratua për punën e strehimit, këto janë fonde që vijnë nga Ministria pse nuk është vazhduar se nuk është dëgjuar që kjo punë të jetë vazhduar.

Edison Memolla . Është pjesa anë teknike ta tha tani do nisim, kanë procedurë nuk është se fillon...

Mitat Daja . Dakord por është një problem shumë i madh dhe puna e asaj rrugës së malësisë që u bë u vonua aq shumë tani ato që janë pjesë e kësaj pune duhet të japin pak llogari se pse është vonuar. Se ti kur e sjell në Këshill dhe Këshilli ta miraton ...

Edison Memolla . Ju doni njëherë ne duam 10 herë por janë ca procedura që nuk i kalojmë dot.

Mitat Daja . Problemi është se ju se keni dashur se po ta kishit dashur ishte bërë.

Edison Memolla . Këtë e thua ti është e pavërtetë se aq e dua unë atë ...

Mitat Daja . Ka kuptim figurativ nuk ka kuptim që nuk do njeri me bërë atë ...

Enkela Ballabani . Unë nuk jam vetëm drejtoresha juridike jam kryetarja e njësisë së prokurimeve për sa i përket hedhjes dhe të gjithë procedurave në sistem. Po të kthej përgjigje për sa i përket rrugës së malësisë ndryshe siç është hedhur në sistem rrugës së Sinaballaj. Procedura e tenderimit përveç se ka procedura ligjore të cilat nga momenti që fillon deri në momentin që mbyllet me lidhjen e kontratës duhet të respektohet nga fillimi në fund. Rruga e Sinaballes është hedhur si tender diku nga Shtatori procedura vijoi dhe më pas është anuluar për arsye ligjore është rihedhur aktualisht është akoma në sistem është bërë vlerësimi nga KVO-ja presim të kalojnë afatet ligjore për sa i përket afateve të ankimeve do vazhdohet më pas me lidhjen e kontratës në varësi të procedurave ligjore siç i përcakton ligji.



Mitat Daja . Po për strehimin që u miratua...

Enkela Ballabani . Për strehimin pati është hedhur diku po në Shtator në mos gaboj...

Mitat Daja . Shumë vonë Shtatori.

Enkela Ballabani . Më fal, tani është projekti vjen projekti nga inxhinierë nuk është një gjë që vjen fondi dhe do e hedhim direkt ka procedura.

Edison Memolla . Është bërë projekt i veçantë për 25-familje.

Enkela Ballabani . Janë parashikuar të gjitha procedurat çfarë do i bëhet për çdo lloj familje që përfiton.

Mitat Daja . Nëse ti planifikon që ta hedhësh një tender në Tetor normalisht afatet ligjore janë që pengojnë shumë gjëra.

Enkela Ballabani . Do të kthej përgjigje dhe pse është rihedhur edhe njëherë procedura e banesave. Procedura e banesave është hedhur sepse në procedurën e parë pati vetëm një operator ekonomik që u fitua, ky operator ekonomik nuk i përmbushte kushtet ligjore për të fituar atë tender dhe në këtë moment tenderi është anuluar për aq kohë sa nuk pati fitues dhe është rihedhur edhe në këtë procedurë jemi aktualisht po në afatet të cilat presim nëse do të ketë ankimime apo jo dhe më pas lidhjen e kontratës.

Silvana Aliu . Je pak kontradiktore në momentin që thua fitoi pastaj s'plotësonte kushtet.

Enkela Ballabani . Nuk thashë e fitoi dhe nuk plotësonte kushtet të lutem operatori ekonomik që hyri herën e parë ishte vetëm një, thashë ... të lutem tani mos më shtoni fjalë të cilat nuk i thashë soe dëgjojeni taman ose... Ai person operatori ekonomik nuk e fitoi atë tender sepse nuk përmbushte kushtet ligjore, herën e parë u anulua procedura është rihedhur dhe aktualisht është akoma në vijim.

Indrit Dedej . Sa tendera ke ti që ke hedhur si Bashki dhe e kanë fituar një operator, ke të ngjashme ti që ka fituar një operator?

Edison Memolla . Nuk ka qenë i rregullt ...



Enkela Ballabani . Ai personi nuk e fitonte unë tani nuk mundem, jo unë por njësia nuk mund të bëj një vlerësim për një operator të cilin nuk plotëson kushtet.

Indrit Dedej . Unë po them këtë që ju keni dhënë tendera që ka pasur vetëm një operator. Sa tendera dua ta dëgjoj nga ti se ti je shefja, sa tendera ke që i ka dhënë Bashkia me një operator?

Enkela Ballabani . Tani nuk i mbaj mend të gjitha nëse te duhet vi me një relacion.

Indrit Dedej . Atëherë nuk i mban mend ti flet sipas interesit.

Edison Memolla . Një operator kur i ka të rregullta ti nuk e anullos dot, nëse nuk i ka të rregullta do e anullos.

Enkela Ballabani . Unë të jap llogari për pjesën si njësi e prokurimit, si kryetare në fillim dhe kam qenë dhe anëtare, si njësi e prokurimit. Përsa i përket vlerësimeve është një komision komplet ndryshe nga unë që bën vlerësimin e atyre kushteve që ve unë për operatorët ekonomik që hyjnë në tender e fiton apo se fiton njëri kjo nuk varet nga unë sepse është komplet komision tjetër që bën vlerësimin.

Hekuran Xhani . Tani jam plotësisht dakord që se ka fituar njeri atë tender. Në rast se kjo metodë dështon prap sepse këto janë njerëz 25 familje këtu unë mbështes diskutimin e Mitatit që 25 familje të paktën atë që kam propozuar unë për fshatin tim çfarë bien jashtë i futet brenda. Tani ne e miratuar në Shkurt po vjen Shkurti prap tani a ka rrugë të mesme, rrugë më të shkurtër për të ja arritur qëllimit sepse do vijë prap një operator që nuk plotëson kushtet ligjore.

Enkela Ballabani . Jo nuk do vijë prap një operator që nuk plotëson kushtet sepse për banesat aktualisht, se procedurën që kemi aktualisht... Po diku nga Qershori, Korriku dhe më pas në Gusht na erdhi projekti dhe në Shtator kemi bërë të gjithë procedurat ligjore dhe kemi hedhur pastaj DST-të në sistem. Përsa i përket aktualisht procedurës që është aktualisht në sistem nuk ka mundësi që të dalë një sepse ka dalë aktualisht një fitues paraprak, ne po presim që të përfundojë afati i ankimimit që kanë operatorët e tjerë që mund të kenë natyrisht siç e përcakton ligji mund të kenë pretendime për këtë tender po presim këtë afat nëse plotësohet afati do kalojmë me fituesin përfundimtar më pas me lidhjen e kontratës siç e parashikon ligji.

Hekuran Xhani . Rrezikohen këto fonde me mbylljen e vitit 2024 se mos digjen?

Enkela Ballabani . Jo se prandaj është parashikuar për t'i kaluar pastaj.



Hekuran Xhani . Jo se po u dogjën përshpejtoni procedurat t’i mbyllni.

Enkela Ballabani . Tani unë e përshpejtoj procedurën të lutem por unë kam afate ligjore që duhet t’i respektoj.

Hekuran Xhani . Nejse faleminderit për sqarimin.

Enver Memolla . Meqenëse jemi tek buxheti 2025-2027 doja një përgjigje nga drejtoria e financës na u përmend eskavatori, nafta eskavatori për bujqësinë në këtë tre vjeçar a ka një projekt konkret nga Bashkia Rrogozhinë një plan të miratuar të detajuar se çfarë është proekti ku fillon ku mbaron dhe sa është shuma që kërkon ky buxhet për tre vite? Siç keni parashikuar...

Edison Memolla . Për karburantin po flasim apo pjesë të tjera të projektit?

Enver Memolla . Për projektet për infrastrukturën bujqësore.

Edison Memolla . Kemi pastrimin e gjithë kanaleve, se eskavatori nuk ka nevojë më për projekte thjeshtë ne do shkojmë tek emergjencat që është paraprake që është referuar nga gjithë banorët pastaj do shkojmë... mjeti ka një konsum ditor po të punojë 6-8 orë.

Enver Memolla . Kryetar më fal kur bëhet një buxhet parashikohen...

Edison Memolla . Është afamesmi nuk është ...

Enver Memolla . Afatmesëm por bëhet fjalë për tre vjeçarin siç ke lagjen nr.1 që e ke 2 milion lekë të reja në vit për shlyerjen në tre, po bëj një pyetje për sektorin e bujqësisë nga ana e infrastrukturës që ka sektori i bujqësisë , a ka një projekt ose një plan pune të saktë të menduar nga drejtoria e bujqësisë ku ka aq km linearë aq metra, aq metra kub që ka bërë një kërkesë për kaq fond që për këto tre vite që ka bërë një kërkesë për kaq fond në këto tre vite dhe çfarë mund të jetë realizimi?

Elton Xhani . Për sa i përket planit të punës ne ecim me plan pune mujor edhe i kemi të evidentuara të gjithë problematikat që kemi me kanalet e dyta që na takojnë ne dhe me ato po merremi pjesa e Rrogozhinës pastaj do fillojmë me njësitë administrative.

Enver Memolla . Tek buxheti afatmesëm sa e ke prashikuar 2025, buxhetin aktual?



Rezart Vogli . Tek buxheti afatmesëm për parashikimin për 2025 për menaxhimin e ujitjes dhe kullimit për paga dhe sigurime është 4 milion e 755 lekë...

Enver Memolla . Investime, investime?

Rezart Vogli . Për shpenzime korrente të tjera është 14 milion e 464 mijë lekë.

Enver Memolla . Të reja, a të vjetra?

Rezart Vogli . Flas për të reja.

Enver Memolla . 140 milion lekë?

Rezart Vogli . 144 milion lekë, parashikimi fillestar viti 2025.

Elton Xhani . Duke qenë se mjeti që kishim ju shtua dhe një mjet tjetër unë e pashë të llogjikshme që të paguhet vetëm pjesa e naftës ky mjet mos pushoi së punuari se problematikat këto janë.

Enver Memolla . Këtu ishte llogjika në bazë të projektit të punës që do bësh ti, sa është fondi? Këtë ma dhe faleminderit.

Erind Tosku . Një pyetje kisha për shefin e financës. Ky fondi që thatë do i japë MZSH-së ...

Rezart Vogli . Atëherë gjatë vitit 2024, në Këshill Bashkiak kërkuam detajimin për një fond të akorduar nga emergjencat civile për blerjen e një eskavatori i cili u realizua me sukses në masën 93 %. Atë fond kërkuam ne për blerje mjetesh teknologjike...

Erind Tosku . Po këtë fondin e këtij viti...?

Edison Memolla . Blerjen e një zjarrfikësje që të jetë për malore dhe blerjen e një mjeti tjetër po për zjarrfikësen.

Rezart Vogli . Jemi para faktit që nuk kemi vlerën fikse që do alokojë shteti për Bashkinë Rrogozhinë.



Indrit Dedej . E kisha me drejtorin e bujqësisë. Si ka mundësi që komisioni i auditit të brendshëm i juaji të ka nxjerr pa projekt fare, pa plan pa projekt.

Elton Xhani . Planet e punës i kam dërguar nuk e di se çfarë ka shkruar aty.

Indrit Dedej . E ka shprehur vetë në Nëntor, audit i brendshëm i juaji, verifikojë dhe më...

Erind Tosku . Ndonjë pyetje tjetër për buxhetin afatmesëm, paqartësi?

Hekuran Xhani . Unë kam diçka po me përgjegjës të zyrës së bujqësisë. Është mirë në bashkëpunim dhe me drejtuesit e njësive administrative të bëhet një planifikim në fillim të vitit. Njësia Administrative Sinaballaj 12 km kanale të dyta dhe ne të vijmë këtu me projekte të detajuara, Njësia Administrative Gosë 15, Njësia Administrative Lekaj 12, Kryevidhi 17 ta dimë dhe ne sa investohet të paktën unë jam përfaqësues në Lekaj, sa ndiqen rrugët për Njësinë Administrative Lekaj për vitin 2024 në 2025 sa do hidhet? kjo të jetë për të gjithë njësitë që kur të vijmë këshilltarët të kenë informacionin e saktë për zonën që dhe ne mos diskutojmë pra unë vi të them ke sjellë projektin pra këto planet që thotë Indriti bëhen në fillim të vitit edhe sa janë realizuar pra analiza në fund të vitit del pra nga 15 që kishe në Komunën Lekaj sa janë realizuar? 13 ose 14 ose kam bërë 2 km më tepër të vijmë dhe faktikisht këto plane që thotë Indriti duhen deri të paktën mbledhjen tjetër të jenë të detajuara si përgjegjës i zyrës së bujqësisë. Kaq km në Lekaj, kaq në Gosë kaq në Sinaballaj, kaq në Rrogozhinë kjo të ndihmon edhe ty por na ndihmon edhe ne për informacion. Plus dhe shefin e financave e ndihmon për shpërndarjen e financave.

Elton Xhani . Unë i kam të gjitha jo vetëm të Rrogozhinës por dhe të Njësive Administrative, të gjithë km e kanaleve të dyta.

Edison Memolla . Do ja sjellësh çfarë keni bërë në 2024 dhe çfarë do bësh në 2025.

Elton Xhani . Deri tani ju kam sjellë vetëm ato që kam realizuar.

Hekuran Xhani . Sepse mbi bazën e metrave dhe kilometrave shpërndahet dhe fondi. Psh 12 km herë kaq lekë, kaq lekë janë investuar në Njësinë Administrative Lekaj kaq, edhe qytetarët ta dinë edhe Këshilltarët të kenë informacion më të detajuar.

Sokol Gosa . Rezo kishit planifikuar blerjen e një zjarrfikëse. Po për mjete tjera se Bashkia jonë ka nevojë dhe për mjete tjera psh një vinç.



Edison Memolla . Kemi bërë një kërkesë se aq e kemi buxhetin...

Sokol Gosa . Flas për planin...

Edison Memolla . Nëse ne do na miratojnë më shumë fonde po flasim për një kosh për dritat, po flasim për një eskavator për Njësitë Administrative janë mjete që ne kemi çuar kërkesë tek emergjencat civile, kemi çuar për lumin Shkumbin që gërryen tokat atje kemi dërguar për urën që është në Gërmenj që mbytet poshtë me një fjalë kemi dërguar shumë projekte shumë kërkesa...

Sokol Gosa . Po flas për mjetet më shumë...

Edison Memolla . Mjetet po shkojmë tek zjarrfikësja këtë vit sepse e patë shumë mirë se çfarë na ndodh.

Erind Tosku . Atëherë e hedhim në votim pikën 10. Edhe njëherë hedhim në votim pikën 10. Kundra z. Indrit pro, kundra? Kundra ok. Atëherë 3 kundër...

Silvana Aliu . Katër.

Indrit Dedej . Katër.

Erind Tosku . 4 (katër) kundra, 11 (njëmbëdhjetë) pro. Miratohet.

-Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 4 (katër) vota kundër (H.Xhani, S.Aliu, I.Dedej, L.Dedej), 0 (zero) vota abstenim pika 10 (dhjetë) e rendit të ditës.

Vendim nr .63. Miratohet me 11 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën Nr.5248.Prot, datë 18.12.2024 “Relacioni i Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Erind Toksu . Kalojmë në pikën 11, “Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025”. Relaton drejtori i financave z. Rezart Vogli.

Rezart Vogli . Atëherë për diskutimin dhe miratimin e projektbuxhetit të bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025 legjislacioni në të cilin është mbështetur Bashkia është si më poshtë ligji nr.150/2014, ligji nr.139/2015, ligji nr. 68/2017 dhe ligji nr.9986. Atëherë pas përfundimit të



buxhetit faktikdrejtuar nga Grupi i Punës i përbërë nga Drejtuesit Kryesorë të Bashkisë,ku bëjnë pjesë edhe Drejtorët e Drejtorive Përkatese, është marrë inisiativa pas ardhjes ndoshta jo përfundimtare të fondit të Trasfertes së shtetit dmth pak më parë ju ishit vetë koshientë që shteti ka akoruar prap fonde për bashkinë Rrogozhinë.

Trasferta e Pakushtëzuar për vitin 2025 nuk ka ndonjë ndryshim të madh përveç rritjes së përcaktuar më parë që i përket rritjes me 5% të treguesve më kryesorë, por ajo që është e rëndësishme është se qeveria Shqiptare në kuadër të rritjes së pagave ka dërguar vetëm për këtë qëllim një rritje shtesë fondi prej 37,781 milion lekë të reja, që i korespondon një mbulimi të Fondit të Pagave për 2.5 muaj të vitit 2025 .

Edhe Buxheti i vitit 2025 si përherë është i përbërë në disa ndarje kryesore që janë:

Të Ardhurat:

Buxheti i Pakushtëzuar i Qeverisjes Vendore për vitin 2025

Buxheti i Pakushtëzuar për Funkzionet shtesë për vitin 2025.

Grantet e trashëguara nga viti 2024 për vitin 2025. (Fonde nga Granti i Pakushtëzuar Vendor dhe Funkzionet Shtesë)

Të ardhurat e planifikuara sipas paketës fiskale për vitin 2025.

Ndërsa për Shpenzimet do përmend:

Shpenzimet për pagat dhe Sigurimet shoqërore

Shpenzimet Operative për mallra e Shërbime, ku përfshihen edhe shpenzimet për këshilltarët dhe administratorët e fshatrave dhe ndihmat për familjet në nevojë.

Shpenzimet për Emergjenca, Kontigjenca dhe Fondi Rezerve.

Dhe shpenzime kapitale për shtimin dhe mirëmbajtjen e Aktiveve Kapitale nëpërmjet Investimeve Direkte.

Të hyrat për vitin 2025 për Bashkinë Rrogozhinë janë :

Të Ardhura nga Granti i Trashëguar 2024 në Shumën 110,877,004 lekë

1. Vlera e Trashëguara nga të Ardhurat e Vitit 2024 në shumën 16,050,903 lekë që përfaqëson shumat e pa alokuara (çelura) të të Ardhurave deri ne fund të Dhjetorit.
2. Granti i Pakushtëzuar i Qeverisjes Vendore në shumën 205.765.000 lekë, fond transferta e pakushtëzuar për vitin 2025 nga ana e shtetit duke llogaritur edhe shtesën që paracitova pak më parë shtesi fondi Pagash në shumën 37,781,000 lekë.
3. Grant i Pakushtëzuar i Mbetjeve Urbane ne Shumen 17,295,000 lekë, jemi në vitin e tretë që qeveria shqiptare akordon buxhet shtesë për bashkinë Rrogozhinë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, të cilat transportohen në qytetin e Elbasanit.
4. Grant i Pakushtëzuar i Mbetjeve Urbane i trashëguar nga viti 2024 ne Shumen 8,987,410 lekë.



5. Granti i Trashëguar nga Fondi i Rindërtimit dmth është i disati vit që Bashkia Rrogozhinë është në proces të objekteve arsimore për rindërtim dhe banesave individuale.
6. Granti i Trashëguar nga Fondi i Rindërtimit për vitin 2024 për ndërtesat arsimore në shumën 8,668,650 lekë, është një fond i papërdorur për vitin 2024 që trashëgohet në vitin 2025.
7. Të ardhurat të Planifikuara për vitin 2025 në shumën 278,943,558 lekë, kjo pasqyrohet në planin e të Ardhurave bashkëngjitur Buxhetit. Kjo nuk është e njëjtë me vitin e kaluar duke pësuar një rritje të lehtë 5%.

Për Grantet e Funksioneve shtesë ose transfertat sektoriale për vitin 2025 kemi:

- Të Ardhurat nga granti për vitin 2025 për Arsimin Parashkollor në shumën 48,325,000 lekë nga 43,747,000 më shumë se vitin e kaluar ose + 4,578,000 lekë më shumë se viti i kaluar me një rritje prej 32.5% .
- Të Ardhurat nga granti për vitin 2025 për Arsimin Parauniversitar në shumën 3,037,000 lekë me një shtesë prej 117.000 lekë nga viti i kaluar me 4.0% rritje.
- Të Ardhurat nga granti për vitin 2025 për Ujitjen dhe kullimin 11,605,000 lekë nga 11,159,000 lekë vitin e kaluar + 446,000 lekë për vitin 2025 ose me 4.0% rritje nga viti 2024 .
- Të Ardhurat nga granti viti 2025 për Pyjet në masën 1,791,000 lekë nga 1,722,000 lekë për vitin 2024 + 69.000 lekë më shumë ose 4.0% më shumë nga viti 2024.
- Të Ardhurat nga granti viti 2025 për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në vlerën 19,011,000 lekë 15,037,000 lekë ose me një rritje prej + 3,974,000 lekë ose me një rritje 26.4% më shumë nga viti 2024.
- Të hyrat gjithsej janë për funksionet shtesë janë 91,333,000 lekë për vitin 2025 nga 74,585,000 lekë që ishte Granti 2024 ose gati 11.0% më shumë . Gjithashtu kemi edhe Grante të trashëguara nga Fondet Specifike .

Buxheti i vitit 2025 sipas shumave totale është :

- të ardhura nga granti i vitit 2024.....110,877,004 lekë
- të ardhura të trashëguara nga viti 202416.050.903 lekë
Të cilat priten siç e thashë nga muaji Dhjetor që është muaj që nuk është mbyllur akoma dhe ne kemi parashikimet tona si për planin e të ardhurave si për shpenzime deri në mbylljen e fundvitit.
- të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar viti 2025.....205,765,000 lekë

Në total të ardhurat për vitin 2025 janë 777.211.922 lekë

Buxheti i parashikuar në total për vitin 2025 shtrihet në proqramet për menaxhimin, planifikimin dhe administrimin që është aparati i bashkisë Rrogozhinë për paga dhe sigurime është akorduar fondi dmth është shpërndarë fondi 199 milion lekë e 773 mijë e 950 lekë. Për kontributet sigurimet shoqërore dhe shëndetësore fondi 33 milion e 111 mijë, për mallra dhe shërbime është



menduar fondi nga kërkesat duke parë kërkesat dhe rëndësinë që ka secili objekt arsimor apo objekt tjetër që përfshin territori i bashkisë Rrogozhinë në masën 49 milion lekë e 899 mijë. Të tjera shpenzime korrente që është artikulli 604 këtu futet transferta e cila i përket këshillit të qarkut në masën 1 milion e 560 mijë lek, shpenzime për emergjencat kontigjencat dhe fondin rezervë në masën 29 milion e 067 mijë lekë. Këtu duhet të them që është ai parashikimi që ne kemi për fondin e ardhur nga buxheti i shtetit për emergjencat civile që mund të vijë gjatë muajit Shkurt ose Mars që është fond që i shtohet kësaj vlerës, se s'kemi si e parashikojmë në këto momente. Transferta për buxhetet familjare dhe individë është ndihma ekonomike 3% që ne miratojmë në këshillin bashkiak është në masën 3 milion e 781 mijë e 107 lekë. Për shpenzime kapitale për projekte dhe studime Bashkia Rrogozhinë ka menduar buxhetin prej 8 milion e 965 mijë lekë për vitin 2025 këtu duke parashikuar që një nga projektet që ka Bashkia Rrogozhinë për vitin 2025 dhe një studim projektim për një rrugë i një njësie të qytetit të Bashkisë së Rrogozhinës për shpenzimet kapitale në masën 86 milion lekë e 127 mijë në total për aparatën buxheti shpërndahet 412 milion lekë të reja për vitin 2025. Për trashëgiminë kulturore për paga dhe sigurime akordohet fondi 3 milion e 773 mijë e 721 lekë për sigurimet shoqërore 681 mijë e 240 lekë dhe për shpenzime dhe mallra dhe shërbime 3 milion e 415 mijë lekë. Në total për kulturën trashëgiminë kulturore evente artistike dhe të tjera është në masën 7 milion 869 mijë e 961 lekë. Për sportin dhe argëtimin vetëm për mallra dhe shërbime për vitin 2025 është akorduar fondi 24 milion lekë e 152 mijë e 400 këtu duhet të përfshi krahas shpenzimeve të tjera që janë pothuajse çdo vit për vitin 2025 duke qenë se në bashkinë e Rrogozhinës organizhet edhe kampionati europian për 17-vjeçarët Bashkia Rrogozhinë është një nga qytetet që do organizojë, Bashkia kemi menduar që të organizojmë me këtë rast disa evenimente ose ngjarje kulturore artistike festive në qytet që ti vijë në ndihmë atyre pak turistëve dhe atyre pak tifozdashësve që do vijnë në qytetin tonë. Për arsimin bazë dhe parashkollor për mallra dhe shërbime për vitin 2025 nga granti i trashëguar është në masën 22 milion e 101 mijë. Për arsimin bazë dhe parashkollor për vitin 2025 nga fondet e grantit dhe nga fondet e parashikuara të mblidhen nga ana e bashkisë Rrogozhinë për paga dhe sigurime janë në masën 49 milion e 924 mijë për shpenzime operative në masën 3 milion lekë. Këtu duhet të fus tek ky zë më shumë është përcaktuar pjesa e ngrohjeve që kanë ambientet arsimore që kanë dru zjarri, pelet. Për menaxhimin e ujitjes dhe kullimit siç e thamë dhe pak më parë e cituam tek buxheti afatmesëm dhënie, dhamë një përafërsi të shifrave buxheti i vitit aktual për shpenzime të pagave dhe sigurimeve . Për shpenzimet e pagave për menaxhimin e ujitjes dhe kullimit kemi fondin 1 milion e 605 mijë e 265 lekë dhe për sigurime 183 mijë e 015 lekë. Për pjesën e shpenzimeve operative ose të tjera korrente për bashkinë Rrogozhinë për vitin 2025 është fondi 17 milion e 818 mijë lekë. Administrimi i pyjeve dhe kullotave është një tjetër sektor ku Bashkia e Rrogozhinës pret të ketë diçka ndryshe për vitin 2025, krahasa pagave sigurimeve është menduar dhe është parashikuar që për pyjet dhe kullotat e Bashkisë Rrogozhinë të ketë një plan për



mbarështrimin e pjesës së gjelbër. Mrojtjen nga zjarri e thamë përveç pagave sigurimeve dhe shpenzimeve operative të cilat mbulojnë pajisjet që i vijnë në ndihmë stacionit të MZSH-së, presim dhe pjesën e fondit të emergjencave për t'i shtuar flotës së tyre dhe një mjet. Në total fondi për zjarrfikësen është 29 milion e 218 mijë lekë.

Mitat Daja . Me të reja?

Rezart Vogli . 29 milion lekë, çdo gjë është me të reja. Për menaxhimin e mbetjeve urbane krahas fondit të akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 thamë që është dhe fondi i cili do të trashëgohet nga buxheti i vitit 2024, në total fondi për mbetjet urbane të bashkisë së Rrogozhinës është në masën 26 milion e 282 mijë e 410 lekë. Për pagat dhe sigurimet në total Bashkia e Rrogozhinës ka 217 milion lekë :

1.Pagat	217,582,720.59	35.6%
2.Sigurimet shoqerore	38,626,999.52	6.3%
3.Mallra dhe sherbime	225,917,711.50	36.9%
4.Trasferta Kesh.qarku	1,560,600.00	0.26%
5.Shpenzime emergjente	29,067,345.00	6.11%
6.Trasferta buxh.familje	3,718,107.00	4.75%
7.Shpenzime kap.projekte	8,965,000.00	1.5%
8.Shp.Kap.te trupezuara ,investimet	86,327,493.00	14.11%

Gjithashtu në këtë buxhet kemi parashikuar dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve për Bashkinë Qendër, Njësotë Administrative dhe Policia Bashkiake numri i punonjësve është 238 një ndryshim shumë të vogël ka do e citoj pak më poshtë se cili do jetë ndryshimi. Për punonjësit me kontratë sezonal parashikimi është për 57 punonjës, kjo kur bashkia e Rrogozhinës ka nevojë të ndërhyjë në rastet e fatkeqësive natyrore ose në kohën e plazhit. Punonjës kulture janë 6 punonjës për gjendjen civile 4 punonjës për arsimin parashkollor numri i punonjësve është 47 për arsimin parauniversitar numri i punonjësve është 4, për administrimin e pyjeve numri i punonjësve është 3, për ujitjen dhe kullimin numri i punonjësve është 3, për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin numri i punonjësve është 17, ishte 14 gjatë vitit që lam pas kemi pasur dhe një ndërhyrje në strukturën e MZSH-së ku morëm përsipër shtimin e numrit dhe mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimin e tyre me të ardhurat e bashkisë. Në këtë vit ndryshe nga vitet e tjera programi “Tungjatjeta Jetë” është mednuar dhe është parë që të jetë një program i cili t’i bashkëngjitet strukturës së bashkisë Rrogozhinë. Dmth qeveria Ministria e linjës do përcaktojë dmth e kemi dakordësinë, e kemi informacion të sigurt që do vazhdojë financimi me 50% i këtij projekti por është menduar që stafi i këtij projekti të jenë pjesë e bashkisë Rrogozhinë me qëllim që pagat e këtij stafi të jenë të unifikuara dhe të jenë njësoj me pjesën tjetër të



specialistëve. Dmth unë po përcaktoj numrin e punonjësve. Dmth them stafi do ketë 6 punonjës se cilët janë punonjësit dhe cilët janë emrat.

Enver Memolla . Po ndërhyj nga ana teknike dhe po ja ndërpres fjalën drejtorit shoh një lapsus këtu tek numri i punonjësve tek totali thotë 383 me shkrim 369 .

Rezart Vogli . Ku?

Enver Memolla . Tek tabela përpara shoh një lapsus...

Rezart Vogli . Ah ndjesë!

Enver Memolla . 369 dhe po t'i mbledhësh dalin 385, se do shkojmë tek lapsuset prap.

Mitat Daja . Është bërë gabim 383.

Enver Memolla . Numri i saktë del 385, dhe jo 383 me shkrim e ke 369 janë tre gabime njëkohësisht në një tabelë.

Edison Memolla .Tabela është kjo këtu që kemi përballë 238 plus ato poshtë.

Enver Memolla . Totali del 385.

Edison Memolla . Nëse është ajo, ajo është totali.

Enver Memolla . Është lapsus?

Rezart Vogli . Lapsus. Faktikisht unë doja...

Enver Memolla . me shkrim i ke 369, e ke dhe poshtë 45, 44 me ... E kam për ju jo për mua...

Rezart Vogli . Ke shumë të drejtë faktikisht unë ta kisha filluar ndryshe diskutimin duhet të parashtroja se dhe nga diskutimi i mbledhjes së komisionit kishte një lapsus nga ana jonë , një përvëmendje në hedhjen e ktyre por dua të them që koha dhe kushtet tona për përgatitjen e këtij buxheti kanë qenë shumë emergjente.

Altin Tosku . Pse je jashtë ti, në zyrë ke qenë.



Enver Memolla . Tani tek parashikimi i punonjësve po shkoj tek mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimin mesa mbaj mend kur ka dhënë relacionin shefi i zjarrfikëses mesa di struktura e tyre është 21 punonjës .

Ediosn Memolla . Struktura e tyre ka qenë 15 ne bashkërisht me vednimin e juaj...

Enver Memolla . Kërkesa ka qenë për 21 punonjës.

Rezart Vogli . Ver më fal se kam qenë dhe pjesë , sipas ligjit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin numri i stafit duhet të ishte në proporcion me nurmin e banorëve të qytetit , duhet të ishte 21. Por duke qenë se numri i popullsisë së qytetit tonë ka ndryshuar dhe nuk është më ai...

Indrit Dedej . Kush e ka verifikuar?

Edison Memolla . Ne e kaluam këtë vit ishte më i mirë menaxhimi me 17.

Enver Memolla . Dhe diçka tjetër Rezo kjo tabelë nuk lexohet...

Indrit Dedej , Dhe firma nuk ka.

Enver Memolla . Kam kërkuar nga Tetori me shkrim kjo tabela mos vijë kaq se nuk lexohet, ke format A3 bëje më të madh ta lexojmë. Dhe e dyta gjithmonë kam vërejtur që projektvendimet vijnë pa numër rendor faqesh dhe pa vulë lidhëse...

Indrit Dedej . I ndërrojnë rrugës, miratojmë këtu ne i ndërrojnë ata.

Enver Memolla . E kemi kërkuar shumë herë këtë pjesë është hera e tretë që e them, pa faqe dhe pa vulë lidhëse.

Rezart Vogli . Nëse duhet pse jo dhe nga mbledhja e ardhshme çdo gjë të jetë me vulë lidhëse.

Enver Memolla . Dhe thashë kjo tabelë për mua është e paqartë se kam lexuar dot nuk e deshifroj dot.

Indrit Dedej . As firmë as vulë në fund.

Enver Memolla . Firma vihet në fund të projektvendimit.



Edison Memolla . Cfarë zëri është?

Enver Memolla . Nuk e lexoj dot çfarë zëri është, të ishin në A3 të paktën.

Edison Memolla . E ke dhe në mënyrë online.

Enver Memolla . Të rrijmë online në telefon me kaq faqe?!

Edison Memolla . Të na e kishit kërkuar më të madh më të madh e bënim se nuk ...

Rezart Vogli . Është mundësia.

Enver Memolla . Është mundësia prandaj po them.

Indrit Dedej . Për punën e mjetit të zjarrfikësve, meqë përmendi zjarrfikësen dhe ka dy mesazhe këtu që thotë jam qytetari ... Përshëndetje thotë doja me ditur për zjarret në fshatin Zanbishë tek lagja e Bicerrve djegia e ullinjve u bë një dëm i konsiderueshëm. Çfarë bisedimi keni dhënë...

Enver Memolla . Duhet një plan biznesi komplet i regjistruar me tarifë...

Indrit Dedej . Edhe zjarret që kanë rënë në fshatin Mlik.

Erind Tosku . Tani ndonjë pyetje tjetër rreth buxhetit?

Indrit Dedej . Rreth buxhetit unë personalisht nuk kam asnjë gjë kam vtëm kohën që ka ardhur në limitet e fundit dhe ne nuk jemi të aftë dhe nuk jemi ekspertë për 10 ditë të zbërthejmë buxhetin e juaj...

Altin Tosku . Për tre ditë.

Indrit Dedej . Për tre ditë ku e dimë. Edhe ne jemi kundra.

Rezart Vogli . Propozon diçka për buxhetin?

Indrit Dedej . S’kam ç’propozoj fare, ky buxhet për mua do kohë një muaj kohë.

Rezart Vogli . Edhe sot që flasim bashkë ne buxheti i shtetit ka për të dhënë fonde.



Indrit Dedej . Unë nuk mund të miratoj gjëra që flet ti dhe të miratoj unë.

Rezart Vogli . Është e drejta jote.

Indrit Dedej . Unë po nuk i pashë se dhe ne duam atë tonën unë nuk jam jurist nuk jam ekonomist të zbërthej tabelat tua. Kështu që një buxhet në limitet e fundit është i papranueshëm.

Erind Tosku . Ndonjë pyetje tjetër? A e hedhim në votim pikën nr 11, Shqyrtim dhe miratim i Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025. E hedhim në votim. 11-janë pro, 4 kundër. Miratohet.

Miratohet me 11 (njëmbëdhjetë) vota pro, 4 (katër) kundër (H.Xhani, S.Aliu, I.Dedej, L.Dedej), 0 (zero) abstenim pika 11 e rendit të ditës.

Vendim nr .64. Miratohet me 11 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim, me shkresën Nr.5249. Prot, datë 18.12.2024 “Për diskutimin dhe miratimin e projekt buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë të vitit 2025”.

Edison Memolla . Pse jeni kundër ta marrim vesh, që ta dimë që ta rregullojmë.

Indrit Dedej . Kundra që t’i vijmë në ndihmë qytetarëve.

Edison Memolla . Çfarë ndihme i vjen qytetarëve që e voton kundër?

Indrit Dedej . Unë nuk mund të vi pas valles tuaj.

Edison Memolla . Më fal se po hy unë tani, si po i vjen në ndihmë qytetarëve duke mos e miratuar buxhetin?

Indrit Dedej . Unë buxhetin nuk ta miratoj...

Edison Memolla . Arsyeja? Politikisht apo jo realist?

Indrit Dedej . Është në limitet e fundit...

Edison Memolla . A është brenda ligjit, a të ka ardhur brenda kohës afateve?



Indrit Dedej . Nuk është bredna ligjit se nuk është brenda ligjit...

Edison Memolla . Nuk e ndihmon popullin duke mos e votuar e ndihmon popullin duke dhënë alternativë që duhet kështu, tani ju keni të drejtën e juaj vazhdoni.

Indrit Dedej . O kryetar nuk më ke dhënë ti mundësi për alternativë se ma ke sjellë buxhetin ditët e fundit.

Edison Memolla . Unë kam ardhur prezent në komisionet e juaja që keni bërë këtu kam qenë këtu dhe kam pritur çdo propozim nga ana e pozitës opozitës.

Indrit Dedej . Çfarë na ke dhënë ti ne?

Edison Memolla . Që të gjithë keni qenë ju të paafte të sillni propozimet e duhura nuk është faji im.

Indrit Dedej . Ti nuk na ke pranuar asnjë propozim ne.

Erind Tosku . Kalojmë tek pika 12, Shqyrtim dhe miratim i shkresës, “Kërkesa për të përfituar bursë nxënësit që vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Mesëm Profesional për vitin shkollor 2024-2025”. Relaton drejtori i Arsimit z.O rges Tosku.

Orges Tosku . Përsëritje të gjithëve ! Këto janë bursa për nxënësit e arsimit që ndjekin arsimin e mesëm profesional për vitin 2024-2025. Ministria e ekonomisë në bashkëpunim me shkollën profesionale çdo vit të ri arsimor harton një plan për numrin e bursave dhe ja përcjell bashkive. Për bashkinë Rrogozhinë Ministria përkatëse ka miratuar 15 bursa, kërkesat pranë Bashkisë Rrogozhinë janë 11, kemi dhe një nxënës që e ka propozuar Silvana që do ta shtojmë mbrapa .

Indrit Dedej . Kryetar po të hap letrat unë nuk dalim mirë por doja të lija rehat të kalojë me aq sa kaloi. Po deshe ti ne e nisim këtë lojë.

Orges Tosku . Do bëhet tek mbledhja tjetër për arsye dokumentacioni që të sjellësh vërtetimin e shkollës siç diskutuam.

Erind Tosku . Atëherë ndonjë pyetje për këtë pjesë? Ok e hedhim në votim pikën nr.12. për bursat për arsimin profesional? Alti në votim. Po, të gjithë pro. Miratohet.



-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 12 e rendit të ditës.

Vendim nr.65. Miratohet me 15-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë, Nr.5257.Prot datë 19.12.2024 “Kërkesa për të përfituar bursë nxënësit që vazhdojnë studimet në Institucionet e Arsimit të Mesëm Profesional për vitin shkollor 2024-2025“.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 13, Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë ”. (Pikë e mbartur nga mbledhja e datës 30.10.2024). Relaton drejtoresha e të ardhurave dhe zhvillimit ekonomik znj. Marsida Thartori.

Edison Memolla . Këtë e relatoj unë nuk ka të bëj fare me kontratën aktuale është një plan që ne e kemi aty e kemi sjellë disa herë jam munduar të ja shpjegoj dhe një për një këshilltarëve nuk ka lidhje aspak me kontratën aktuale këto janë plane që siç është kjo kemi dhe me pjesën e arsimit një plan që na ka ndihmuar ambasada Zvicerane dhe ambasada Austriake që na ndihmoi në relatimin e këtyre planeve dhe krijuam një plan që na ndihmoi për të përmirësuar punën tonë por jo që ka ndërhyrje në planin e menaxhimit të mbetjeve.

Erind Tosku . Ndonjë diskutim për këtë pjesë?

Enver Memolla . Për plazhin po flasim.

Erind Tosku . Jo nuk jemi tek plazhi jemi tek plani i menaxhimit të mbetjeve. 13 jemi z. Enver.

Mitat Daja . Ky është thjeshtë studim apo jo?

Erind Tosku . Po pra që bëme dhe tek dëgjesa. E hedhim në votim. Anëtarë ju lutem Fatmira? 14-pro Shpati? Abstenim.

Shpati Kolgega . Nuk e di as çfarë po votojmë tani.

Erind Tosku . Absteno.

-Miratohet me 14 (katërbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër dhe 1 (një) votë abstenim (Sh. Kolgega) pika 13 e rendit të ditës.



Vendim nr.66. Miratohet me 14 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4484.Prot datë 23.10.2024 “Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve Bashkia Rrogozhinë”, si dhe Relacionin Shpjegues për këtë projektvendim me Nr.4481/1.Prot datë 23.10.2024.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 14 “Miratim i hartës së plazhit Spille dhe Vilë Bashtovë Bashkia Rrogozhinë në zbatim të ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”. Fjala për drejtorin e Politikave Urbane z. Tomorr Thartori.

Edison Memolla . Kjo është një hartë që ka qenë dhe vjet nuk asnjë ndryshim ne jemi tek pjesa e qeverisë që thotë është 70, i menaxhuar dhe 30 publik i kemi qëndruar formulës.

Tomorr ThartoriTek Guri i Lëmuar dhe në jug fare Vilë janë shtuar sipërfaqet që nuk do përdoren dmth është krijuar parcela por është publike, i vetmi ndryshim ky ishte.

Erind Tosku . Ndryshime tjera mbarimi i kontratës...?

Tomorr Thartori . Kontratat mbarojnë vitin që vjen në Spille për pjesën tjetër kanë qenë aplikime të hapura.

Erind Tosku . Ndonjë pyetje?

Enver Memolla , Këtu po flasim për kriteret për aplikim?

Tomorr Thartori . Tek miratimi i hartës, aplikimet kanë përfunduar, afati I fundit ka qenë datë 20.

Enver Memolla . Tek harta është ndarë pjesa e taksimit?

Edison Memolla . Jo nuk ka lidhje ajo, tani harta është e njëjta e vitit të kaluar pa ndryshim asnjë gjë 70 / 30, paketa fiskale është po e viti të kaluar pagesa e rërës çdo siç ka qenë thjeshtë kalon me vendim të këshillit bashkiak.

Tomorr Thartori . Harta është miratuar dhe tek Agjensia Kombëtare e Bregdetit edhe tek Ministria e Turizmit, ne vetëm po përcaktojmë.

Enver Memolla . Tek pjesa e stacionit të plazhit me caktimin e qeverisë do lejohen shezllonet më?



Edison Memolla . Problemi është në Vilë sepse Spilleja e ka dhe një vit kontratën. Ne kemi pasur takime të një pas njëshme me të gjithë subjektet që operojnë atje dhe po shikojmë një mundësi që t'i jepet ato beach baret do i kenë, bëhet fjalë për shezllonet për t'i vendosur që akoma nuk kemi një përgjigje të saktë të shikojmë aplikimet që janë mbyllur me datë 20 dhe do shikojmë përgjigjet që do jepen. Bëhet fjalë për Vilë Bashtovën, Spilleja e ka dhe një vit.

Tomorr Thartori . Që të marrësh stacion plazhi me ligjin e ri që doli me VKM-në duhet që ose të jesh strukturë akomoduese e licensuar ose të paktën të jesh në proces licensimi, që me gjetur një rrugë të përbashkët nuk e di sa do të na miratohet për Vilën.

Erind Tosku . Aktualisht nëse nuk kanë miratim stacionet e plazhit që janë.

Edison Memolla . Ato do jenë stacion objekti do ngeli bëhet fjalë për menaxhimin e rërës.

Erind Tosku . I bie që nëse subjekti i bën të paligjshme masat janë gjobë ose sekuestrim të shezlloneve. Ndonjë pyetje për pikën 14?

Fatmira Thartori . Unë po them që t'I gjejmë zgjidhje biznesit që është aty.

Erind Tosku . Atëherë ta hedhim në votim pikën 14? Miratimi I hartës së plazhit Spille dhe Vilë Bashtovës? Këshilltarë për pikën 14 e hedhim në votim? Po 15 pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim pika 14 e rendit të ditës.

Vendim nr.67. Miratohet me 15 vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.4860.Prot datë 18.11.2024 “Për miratimin e Hartës së Plazhit Spille dhe Vilë Bashtovë Bashkia Rrogozhinë, në zbatim të VKM, Nr.649, datë 16.10.2024, për miratimin e Rregullores “ Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit“ , si dhe Relacioni i këtij projektvendimi me Nr.4860/1.Prot datë 18.11.2024.

Erind Tosku . Kalojmë në pikën 15, Miratim i projektvendimit, “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2025”. Po z. Enver.

Enver Memolla . Z. Kryetar i Këshillit këtë vit për muajin Shtator disa plane Korrik dhe Tetor nuk janë zbatuar nga administrata për dhënie informacion si tek PBA si tek Paketa Fiskale si dhe



tek bisedimi i projektbuxhetit si afatmesëm dhe aktual. Do doja shumë që këtë që po miratojmë mos shkelim veten tonë që të mos na ndodhë që ...

Erind Tosku . Ndonjë gjë tjetër për pikën 15? E hedhim në votim? 15 pro miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër. 0 (zero) abstenim, pika 15 e rendit të ditës.

Vendim nr.68. Miratohet me 15-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Zëvendëskryetari i Këshillit, me shkresë Nr.5278.Prot datë 20.12.2024 “Për miratimin e programit të punës të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për vitin 2025“, si dhe Relacioni i projektvendimit me shkresë Nr.5278/1. Prot datë 20.12.2024.

Erind Tosku . Atëherë siç ju thamë në fillim të mbledhjes së këshillit që na erdhi një shkresë. Projektvendimi “Për miratimin e fondit të akorduar nga këshilli i ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Ta kalojmë dhe këtë pikën në votim që ka ardhur fondi për atë. Po 15-pro. Miratohet.

-Miratohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim projektvendimi, “Për miratimin e fondit të akorduar nga këshilli i ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Vendim nr.69. Miratohet me 15-vota pro projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresë Nr.5279.Prot datë 23.12.2024 “Për miratimin e fondit të akorduar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, si dhe Relacioni shpjegues i këtij projektvendimi me shkresë Nr.5279/1.Prot datë 23.12.2024.

Erind Tosku . Pika 16, “Raport mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak, për periudhën Janar-Nëntor 2024 vendimet të cilat nuk janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë si dhe zbatueshmëria e këtyre vendimeve nga ana e administratës së bashkisë”. Materialin e keni të gjithë janë paraqitur të gjithë vendimet e këshillit bashkiak për periudhën 2024. Ndonjë pyetje ndonjë diskutim për raportin? Vendimet që janë marrë thjeshtë është një raport. E hedhim në votim po. 15- pro miratohet.

-Miratohet me 15-vota pro pika 16 e rendit të ditës, “Raport mbi vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak, për periudhën Janar-Nëntor 2024 vendimet të cilat nuk janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë si dhe zbatueshmëria e këtyre vendimeve nga ana e administratës së bashkisë”.



Erind Tosku . Kalojmë tek pika të ndryshme. Shqyrtim i kërkesës së z. Agush Deda. Unë i nënshkruari Agush Deda banor i qytetit Rrogozhinë lagjja nr.2, me anë të kësaj shkrese ju drejtohem ju si këshill bashkiak për ndihmë po ju shqyrtoj problemin tim. Në vitin 1994 kam marrë një hyrje 1+1 në pallat me vendim të këshillit bashkiak Rrogozhinë kam lidhur një kontratë prej 300 mijë lekësh të vjetra por pa të drejtë tapie. Në komunikim me entin e banesave Durrës shtëpia ku unë banoj aktualisht është vlerësuar në vlerën 7 milion e 200 mijë lekë të vjetra. Në kushtet me të cilat jam e kam të pamundur të paguaj vlerën e kërkuar për të marrë tapinë nga informacionet e marra nga punonjës të entit të banesave Durrës të bashkisë në bazë të këtij ligji të caktuar në kushtet e invaliditetit me të cilën unë dhe bashkëshortja ime ndodhem nuk mund të mbuloj këto shpenzime. Ju falenderoj për mirëkuptiomin shpresoj që kërkesa ime të merret parasysh nga Agush Deda. Pra zotëria nuk mund tyë marri tapinë po nuk bëri këtë shlyerjen prej 7 milion 200 mijë lekë të vjetra shpenzim.

Mitat Daja . Si mund të ndihmohet ky Rez që të jetë dhe brenda dhe Prefekti mos e kthejë.

Hekuran Xhani . Ky ka paguar faktikisht nga kjo vlerë në këto vite? Se thotë e kam marrë me vendim këshilli që 1994. Ky ka paguar qeranë?

Rezart Vogli . Nuk ka paguar qeranë, banon në një objekt por nuk ka certifikatën e pronësisë.

Hekuran Xhani . Ky nuk ka shlyer asnjë lloj detyrimi kundrejt kësaj banese? Unë nuk e njoh si problem i takon këshilltarëve të Rrogozhinës.

Enver Memolla . Unë e njoh kush është por nga ana ligjore a ka kompetencë këshilli bashkiak për ta marrë në shqyrtim sepse ne kemi përmblyten njerëz deri 50 mijë lekë i ka këshilli. Flas nga ana juridike a kemi të drejtë ta marrim në shqyrtim apo jo? Pastaj kalojmë tek shifrat nga juridike po flas mos i hyjmë kot shifrave. Shuma që këshilli bashkiak jep është deri 50 mijë lekë të reja, 500 mijë lekë të vjetra.

Erind Tosku . I bie që kjo kërkesa të mos merret parasysh nga Këshilli.

Mitat Daja . Mund të futet tek emergjencat prandaj po pyesim.

Enver Memolla . Unë po flas nga ana e Këshillit.

Erind Tosku . Kjo shkresa i kalon Bashkisë nuk i kalon këshillit për vendim se nuk mund të bëjë këshilli bashkiak miratim fondi.



Edison Memolla . Ne t'i hyjmë ligjërsisht ta shikojmë anën procedurale por kjo është një shumë që me aq sa kemi parë në vendimet e tjera nuk besoj që e mbulon dot me një vendim këshilli. Ne po e marrim në shqyrtim dhe të ju japim një relacion më të detajuar mbledhjen e ardhshme me një projektvendim shoqëruar në se do të jetë e mundur nëse nuk është shkojmë tek ndihma maksimale që ne kemi që ne kemi që ju keni në dispozicion për t'i ndihmuar këto persona.

Mitat Daja . Këshilli ka një kufizim të vogël, ajo që ka këshilli nuk e ndihmon dot.

Edison Memolla . Ne jemi dakord që të ndihmohet sepse është ndihmuar me apartamentin...

Mitat Daja . Ju si Bashki e ndihmoni dot?

Edison Memolla . Është këshilli që vendos.

Erind Tosku . Ja delegojmë bashkisë.

Mitat Daja . Ne paraprakisht vendosim që të ndihmohet ju si Bashki, keni hapësira ligjore që ta ndihmoni?

Edison Memolla . Ta verifikojmë.

Erind Tosku . Në rregull ja kalojmë kërkesën drejtorisë përkatëse të bashkisë.

Edison Memolla . Atëherë ne do e marrim në shqyrtim do shikojmë bazën ligjore, nëse na e lejon baza ligjore do të jua sjellim me projektvendim nëse baza ligjore nuk e lejon do të ngeli thjeshtë një kërkesë.

Erind Tosku . Nuk miratojmë dot. Atëherë tek të ndryshmet ka ndonjë diskutim? Po z. Enver.

Enver Memolla . Tani meqenëse kemi fatin e mirë të kemi drejtoreshën e shërbimeve kam një pyetje. Tani po flas për lagjen time për rrugën Bërdedaj sipas sistemit që është. A keni dalë ndonjëherë në terren për të parë shërbimet që merr ai komunitet atje? Këto kohët e fundit si ujërat e bardha si ujërat e zeza si zënia e rrugëve sepse realisht po shkoj në shtëpi kllaç nuk po na zë më rruga. Kanalizime nuk kemi ndriçimi po cedon tani nuk e di çfarë po ndodh nuk shkoj dot në shtëpi kur bie shi. Janë tre vende që janë pikasur kryetari e di nuk e di të shkoj në shtëpi me makinë apo të shkoj në këmbë. Kryetari e di kush janë tre vendet që kanë bllokuar rrugën.



Edison Memolla . Ne kemi një projekt të bërë të asaj lagjeje ju e dini shumë mirë.

Enver Memolla . Kryetar nuk po flas për projektin unë po flas ke një kryeplak...

Edison Memolla . Zënia e rrugëve po flet?

Enver Memolla . Zënia e rrugëve dhe mosmirëmbajtja, sot nga hekurudha deri lart nuk shkohet. Asfaltimin e kam parasysh do kalojnë afatet kohore doli vera erdhi dimri unë them sot nuk shkohet lart.

Edison Memolla . Ajo lagje ne kemi bërë mirëmbajtje meremtime por nuk është mjaftueshëm.

Enver Memolla . Kryetar po shkon rruga 2.8 m nga 4.

Edison Memolla . Dakord kjo është pjesë tjetër.

Enver Memolla . Këtë po them a keni dalë ndonjëherë në terren, kryeplaku është marrë me këtë pjesë? Se nuk po marrim vesh çfarë po ndodh është muaji i 6-të që po them. Ku duhet ta çojmë e doni me shkresë zyrtare si e doni?

Edison Memolla . Nëse është zënë rruga ka konflikt me shkresë.

Enver Memolla . Për pritjen e ujërave të larta se vjen nga maja malit deri poshtë nuk po marrim vesh tubacione do, dy tubina do është bllokuar rruga tek pompa ujit e re. Njëri nga ata personat po i hy uji në shtëpi sa herë bie shi.

Edison Memolla . Që është investim i madh duhet që është problematikë dihet që është problematikë e kemi ndjekur dhe bashkë kemi shkuar dhe atje.

Enver Memolla . Unë po flas aktualisht janë dy familje që rrezikohen që i shkon uji në oborr për 2 m³ beton dhe një zgarë hekuri, ta jap unë si ta bësh preventivin po nuk e bëri bashkia. Tek pompa uji deviojo ujin ktheje në kanal kryesor nuk kam çfarë them më po ti jap të gjitha mepika të kuqe.

Altin Tosku . Ke një staf punëtorësh.

Edison Memolla . Nëse do duhet me beton e këto gjëra që thotë Veri meremetim është gjë që zgjidhet.



Enver Memolla . Është diçka që është shumë e zgjidhshme, kam që nga Korriku që e them merrni masa merrni masa, jam dakord keni hedhur çakull por nuk ka mbajtur. Është emergjente.

Altin Tosku . Janë disa rrugë tek urat që i themi ne dygrykëshe që është e bllokuar komplet pjesa e kanalit anësor edhe bëhet komplet ajo rëra që vjen është bërë prap rruga shumë keq. Pjesa komplet e kanalit po gërryhet po thuhet komplet edhe trotuari që është bërë ajo pjesa e bordurave është bërë komplet kështu dhe matanë tek rruga e Gjuzve po e njëjta gjë është. Dmth ke një staf punëtorësh që nuk e di tani sa mund të jenë po të paktën gjërat që janë më elementare se ato janë si elementare në sensin e asaj se vijnë shkurret dhe e bllokojnë të paktën të hiqen shkurret.

Indrit Dedej . O z. Tosku në 2027 në buxhetin e 2027.

Erind Tosku . Të gjithë drejtorat mos na shikojnë ne këshilltarët si për të kapur fajin po ju japi disa evidenca që ju mbase nuk i ndiqni dot të gjitha duhet të marrin zgjidhje dhe duhet me vednosur kush është prioritet.

Edison Memolla . Ne jemi dakord që t'i dëgjojmë të gjithë sugjerimet dhe jemi dakord që të marrim masat sepse ndonjëherë ndoshta nuk e, ajo që thotë Veri është e vërtetë e kam parë kam kaluar dhe vetë, se para ca kohësh kam qenë aty kam pasur një vaki dhe e di shumë mirë si është historia kështu që jemi dakord tek ajo pjesë me ndriçim.

Enver Memolla . Më fal edhe diçka komplet rruga e Peqinit bllokuar pusetat.

Edison Memolla . Janë gjethet .

Hekuran Xhani . Kryetar unë kisha një pyetje lidhur me projektin e fshatit.

Edison Memolla . Atëherë për Njësinë Administrative Lekaj dhe për fshatin Luz shtë miratuar projekti është lidhur kontrata me këshillin e Qarkut se ishin ato ndihmëtarë dhe investitorët kryesorë dhe pritet të fillojë investimi shumë shpejt. Janë afatet ligjore që do rishikohet do ribëhen të gjithë rruga që na takon të paktën brenda bashkisë tonë, kemi pasur kontakte me bashkinë Kavajë që dhe ato të ndërhyjnë që të shkojmë ta bëjmë taman ta shikojmë. Kurse për pjesën e Rrogozhinës ajo është 100% që do fillojë punë kështu që kemi lajm të mirë për Luzin.

Fatmira Thartori . Për Njësinë Gosë dhe për njësitë e tjera është bërë shumë problem ndërprerja e energjisë elektrike mbrëmë na kanë ikur dritat natën edhe sot nuk ka drita në Gosë është bërë shumë problematike ndonjëherë sa fryrë fiken dritat , sa të bjerë shi direkt na fiken jemi bërë sikur jemi katund i largët...



Indrit Dedej . Hajde në qytet në Rrogozhinë mos më rri atje.

Fatmira Thartori . Gosën nuk e ndërroj më asnjë gjë, shyqyr që zbrita në qendër isha në mal zbrita në qendër. Tjetër edhe rrugët në lagjen Kërçukaj është bërë shumë problematike.

Edison Memolla . Atë po flisnim për pjesën e lagjes Kërçukaj është pjesa e projektit rishikimit që kemi një buxhet për ta bërë taman me projekt të saktë.

Fatmira Thartori . Ju jeni në qytet por nuk do të thotë që dhe ne tjerët nga Rrogozhina apo nga Gosa të ikim në Durrës, ne shyqyr që po rrijmë këtu t'i nxisim qytetarët tanë që të rrijnë këtu.

Sokol Gosa . Për problemet që ka qyteti i kam ngritur dhe herë të tjera asnjë lloj ndryshimi duke filluar që nga pastrimi sistemimi, koshat parku që është bërë atje. E para pastrimi e dyta ndriçimi janë rrugët hyrëse dalëse të qytetit pa drita është emergjencë. Edjhe diçka meqë është dhe Rezi këtu është ai fondi tek trashëgimia kulturore që bëhet 17 milion lekë është e mira për qytetin tonë të kemi një muzeum. Ne themi trashëgimi kulturore por nuk kemi muzeum, kështu që i shikon këto gjëra me përparësi.

Altin Tosku . Unë doja që t'u shikonte hyrja dhe dalja e fshatit Sinaballaj se është shumë keq dmth futesh direkt ka dhe ferra në anësore kur del nga Sinaballaj që futesh në xhade është shumë keq dmth duhet të bëhet pak 1-2 m të zgjerohet në anësore, se të ketë të paktën të priten ferrat.

Enver Memolla . Siç është bërë në Gjocaj.

Edison Memolla . Nuk do aq shumë ajo thjeshtë ka kur hyn tek hyrja e fshatit se ne e kemi marrë ankesën është shumë e ngushtë nuk kalojnë dy makina njëra me tjetrën kemi bërënjë takim me ARSH-në hiqet gardreni vihet me tubë dhe ke një tip xhepi kur të dalësh.

Altin Tosku . Po por aty ka pasoja aksidente shumë se vjen tjetri me shpejtësi.

Edison Memolla . Duhet ndërhyrje e përbashkët me ARSH-në.

Altin Tosku . E kuptoj thjeshtë duhet me u bërë kërkesa.

Edison Memolla . Është bërë ankimimi dhe lagjja dhe anëtari i këshillit për këtë pjesë, tani e kemi kuptuar se kur thua do zgjeruar rruga anësore, jo do zgjeruar rruga hyrëse e fshatit sepse është më e ngushtë duhet të jetë 5 metra.



Altin Tosku . Dhe anësoret duhen pastruar sepse nuk vjen dot.

Edison Memolla . E zgjidhim se tubat gjërat i kemi vetëm të na japë lejen ARRSH-ja dhe bëhet.

Erind Tosku . Ndonjë diskutim tjetër tek të ndryshmet?

Silvana Aliu . Për 2-3 soba me të drejtë kthimi.

Edison Memolla . Ka soba, po ku për çfarë duhet një relacion dhe kush do marrë përsipër?

Silvana Aliu . Kam folur me komunitetin egjiptian do t'i kthejnë prap .

Erind Tosku . Vetëm sezonin e dimrit?

Silvana Aliu . Po sezonin e dimrit.

Edison Memolla . Shkolla e vjetër “Qamil Gjuzi” ka pasur disa soba aty dhe i kemi në dispozicion disa soba por duhen dhe ku do shkojnë sepse ne i kemi në inventarë dhe kanë disa procedura se ku do shkojnë. Me një kërkesë me një vendim tuajin dhe ja dërgojmë se nuk është problem fare.

Erind Tosku . Ka ndonjë diskutim tjetër? Meqë nuk kemi diskutime të tjera. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe ja jap fjalën kryetarit.

Edison Memolla . Doja të ju uroja për festat e fundvitit qoftë ky vit që iku dhe ai që do vijë të jetë akoma më i mirë se ky që iku një vit të mbarë për të gjithë për familjet e juaja, paçit shëndet, mirësi begati kudo. Kur të doni, po të doni dhe sot Bashkia Rrogozhinë ju fton për drekë ose caktoni ju ditën.

MBYLLET MBLEDHJA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 14 : 00^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 02 orë ; 46 min ; 09 sek.
E ndarë në tre video : 56 min ; 11 sek videoja e parë. 27 min ; 06 sek videoja e dytë dhe 01 orë ; 22 min ; 52 sek videoja e tretë.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 67 (gjashtëdhjetë e shtatë).

Miratohet procesverbali :

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera**